



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 3 DHE 7 PRILL 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 03. I 07. APRILA 2014. GODINE**

**PRILL - APRIL  
2014**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale.

## **Dnevni red**

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Veteranima Oslobodilačke vojske Kosova.
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma garancije za kreditnu liniju Fonda osiguranja depozita na Kosovu preko Vlade Republike Kosova i Evropske banke za obnovu i razvoj,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o medicinskim proizvodima i opremi.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.**

KRYETARI: Urdhëro Ismet, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm për hir të opinionit do të doja të sqaroj që në pikën e fundit të vazhdimit të seancës së paradites, që kishte të bënte me Projektligjin për zgjedhjet, ne e kishim një takim që e ka caktuar më herët grupi ynë dhe ju informova, por nuk arritëm të kthehemi dhe të marrim pjesë në votim.

Më duhet të them për hir të opinionit që ne, ashtu siç është thënë më herët nga zoti Gashi, tash po e them që ne e përkrahim projektligjin, ai ishte votuar, por nuk ka pasur asnjë arsye tjetër që nuk ishim të pranishëm, kështu që edhe kur të vijë në leximin e dytë, ne sigurisht do ta votojmë.

Arsyeja do të thotë ka qenë vetëm që kemi qenë në një mbledhje që e kemi pasur të caktuar më herët dhe që nuk arritëm ta përfundojmë dhe ju e kishit nxjerrë në votim. Kaq kryetar, faleminderit!

KRYETARI: Po, është e vërtetë, me lejen e drejtuesit të seancës keni kërkuar largimin dhe jeni larguar me detyrë. Do të thotë, nuk është që s'keni dashur të jeni në këtë pjesë. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimet në emër të grupeve parlamentare pesë minuta, në emër të deputetëve tre minuta. E dini që replika nuk ka.

Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës, kryeministri Thaçi mori vendim që shpenzimet e regjistrimit të semestrit për të gjithë studentët e Universitetit Publik "Hasan Prishtina" dhe të universiteteve tjera publike në Kosovë të ulen për 50%.

Kjo Qeveri po mendon për të gjitha shtresat e popullsisë, kurse ky vendim është i mirëpritur dhe do të ndikojë ndjeshëm në buxhetin familjar të secilit student, duke krijuar kështu parakushte për një jetë të dinjitetshme. Në kohën kur është bërë rritja e pagave për profesorët, për studentët bachelor, për master dhe për konviktet, si dhe për shpenzimet e mensës janë ulur shpenzimet për 50%.

Sado që ky vendim i kryeministrit mund të duket përkrahje e vogël për studentët dhe për familjet e tyre dhe mbase do të interpretohet si pjesë e fushatës parazgjedhore, duhet ta kemi gjithmonë parasysh faktin se në universitetet publike të Kosovës janë afërsisht 65 deri 70 mijë studentë, që nënkupton se numri i përfituesve nuk është i vogël. Përndryshe, përfiton thuajse çdo e dyta familje kosovare, sepse çdo e dyta familje në Kosovë e ka së paku një student në universitet.

Dhe, e mira tjetër e këtij vendimi është se përfituesit, në këtë rast studentët, nuk kanë ngjyrimë politike, por përfitojnë pa përjashtim, përfshirë edhe familjet që kanë dy deri tre studentë dhe ata me gjendje të rënduar ekonomike.

Ky vendim i kryeministrit të Kosovës mund të duket si investim i vogël, mirëpo është një hallkë e rëndësishme e zinxhirit të një procesi arsimor, nga ai fillor deri te ai universitar, por gjithsesi se këtij vendimi duhet t'i bashkohet edhe ngritja e kapaciteteve promovuese për studentët në konvikte dhe me çmime të arsyeshme.

Prandaj, përfundimisht e përkrah këtë vendim dhe mendoj që kjo do të ndikojë para së gjithash edhe në buxhetin familjar të secilës familje dhe si pjesë të fundit kërkoj që të ketë parasysh edhe te shpenzimet e transportit për secilin student, meqë shumica e vendeve të rajonit i kanë liruar studentët nga shpenzimet e transportit dhe mendoj se kjo do të ndikojë në buxhetin familjar të secilit student. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Qeveria i ka 20 vende këtu, programin dhe punët e saj i mbron vetë Qeveria, deputetët kanë punë të tjera. Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

**HAKI DEMOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Gjatë një vizite në Repartin Intensiv të QKUK-së, një qytetar, duke e ditur se jam deputet më luti që t'i fotografoj gropat në hollin e këtij reparti dhe të njëjtat t'ua shfaq qeveritarëve tanë.

Pasi kohëve të fundit isha i shtyrë ta frekuentoja më shpesh repartin intensiv nga afër e pashë se ky repart është në gjendje të tmerrshme. Ndodh që në të shtrohen pacientët me gjendje tejet kritike, shpesh në komë.

Edhe pse ky është reparti i vetëm i këtillë në Kosovë, tani për tani ka kapacitete për pranimin e vetëm 14 pacientëve.

Duke pasur parasysh gjendjen kritike të pacientëve në vendet e zhvilluara, repartet e tilla vendosen në hapësira ku thuajse garantohet karantina e plotë për pacientët, kurse në QKUK ky repart është i vendosur në një rrugëkryq që lidh Emergjencën me repartet tjera, përfshirë edhe bibliotekën për studentë.

Për këtë arsye, holli i këtij reparti më shumë i ngjan një shëtitoreje, ku kalojnë me qindra persona në ditë, ndërsa përballë dhomës së pacientëve janë tualetet, që shfrytëzohen nga personeli, familjarët e pacientëve dhe kalimtarët e rastit, duke e rritur mundësinë e bartjes së infeksioneve të ndryshme të pacientët, që edhe ashtu e kanë imunitetin dhe shëndetin e rrënuar nga sëmundja.

E meta tjetër e këtij reparti është mungesa e hapësirës për vendosjen e familjarëve të pacientëve, të cilët shërbenin për blerjen dhe sjelljen e medikamenteve për pacientët e tyre. Këta familjarë qëndrojnë në këmbë, pa e pasur një ulësë të vetme, mu sikur të ishin azilkërkues.

Këtij reparti mungon edhe aparatura mjekësore, sepse në dhomën e pacientëve nuk ka as aparat të ultrazërit, as të dializës, për çka pacientët shëndetligë zakonisht buzë vdekjes duhet maltretuar nëpër holle dhe elevatore për t'i dërguar në repartet që i posedojnë këto aparatura.

E meta më e madhe e këtij reparti intensiv të shtetit, sipas 'Bota Press', Qeveria shpenzon mbi 100 milionë euro për mëditjet e zyrtarëve qeveritarë, është se nuk siguron asnjë medikament për këta pacientë.

Barra e furnizimit me medikamente bie mbi familjarët e pacientëve. Ata që janë në gjendje të mirë ekonomike mund të sigurojnë barna, të cilat herë-herë janë shumë të shtrenjta. Për shembull, një grua kishte shpenzuar mbi 23 mijë euro për kurimin 7-mujor të burrit të saj.

Kurse pacientët që vijnë nga familjet e varfra paraprakisht janë të dënuara që të dorëzohen para sëmundjes dhe ta presin vdekjen e tyre dalëngadalë.

Andaj, duke e pasur parasysh gjendjen kaq të rëndë të repartit më të ndjeshëm të QKUK-së, kërkoj nga Ministria e Shëndetësisë, e posaçërisht nga Qeveria e Kosovës që ta reduktojë buxhetin për mëditjet e zyrtarëve qeveritarë dhe mjetet e kursyera t'i përdorë për ndërtimin e objektit të ri për Repartin Intensiv, si dhe me to t'i furnizojë me medikamente pacientët e këtij reparti për të shpëtuar jetën e të sëmurëve të varfër kosovarë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

**FATON TOPALLI:** I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot kur po zhvillohen punimet e kësaj seance, 33 vjet më parë, më 11 e 26 mars, 1 e 2 prill në Prishtinë dhe në qytete tjera të Kosovës, më 3 prill në Ferizaj, qindra e mijëra

qytetarë të Kosovës, studentë, punëtorë, intelektualë kërkuan që Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi t'u njihej statusi i Republikës shqiptare.

Këto demonstrata u shuan me dhunë policore dhe ushtarake. Bilanci i tyre zyrtar ishte 11 të vrarë dhe qindra të plagosur.

Republika shqiptare erdhi si kërkesë e natyrshme, pasi të gjitha republikat tjera në Federatën jugosllave ishin krijuar në bazë të parimit etnik.

Me kërkesat e grupeve të organizuara të asaj kohe, pavarësia politike, ekonomike dhe territoriale e përbënin thelbin e programit politik dhe të kërkesave të shtruuara për zgjidhje.

Sot, 33 vjet më pas, nuk mund të lejojmë të kalojmë kjo ditë pa e bërë një bilanc të shkurtë për të kuptuar çka kërkuan dhe ku jemi sot.

Nëse kërkesa për Republikë kishte për qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar dhe krijimin e sovranitetit politik, ekonomik dhe territorial, Republika e Hashim Thaçit është shndërruar në një republikë pa identitet, pa sovranitet politik, ekonomik dhe territorial dhe pa asnjë element kombëtar, madje pa flamur dhe me një himn memec.

Sovraniteti politik i ndikuar nga jashtë dhe i pranuar nga brenda, si në vitin 1981 nga vasalët e Serbisë në Kosovë, nëpërmjet bisedimeve me Serbinë ka degraduar me atë masë sa i ka shkelur edhe vetë parimet e proklamuar të Kushtetutës së Ahtisarit.

Federalizmi i Kosovës nëpërmjet autonomisë së Bashkësisë së Komunave Serbe është një element tjetër i humbjes së çfarëdo sovraniteti politik.

Krijimi i autonomisë serbe brenda territorit të Kosovës, mohimi i shtetit të Kosovës brenda këtij territori flet për një dështim tjetër për të ruajtur tërësinë territoriale të vendit tonë.

Derisa në vendin tonë nuk prodhojmë për t'i përmbushur as 10% të nevojave, derisa eksportuesi më i madh në Kosovë është Serbia, nuk mund të flasim për një pavarësi ekonomike, madje as nga vetë ata që ne i konsiderojmë si armiq të vendit tonë.

Të gjithë njohësit e rrethanave të asaj kohe, e kam fjalën për vitin 1981, e dinë që një republikë e tipit çfarë kanë ndërtuar pushtetet në Kosovë deri më sot, një republikë pa identitet kombëtar, pa sovranitet ekonomik, politik dhe territorial, pa elemente kombëtare shqiptare, pa flamur dhe me një himn memec, do të ishte e pranueshme edhe për regjimin serb, çka vërtetohet sot me bisedimet e kryeministrit me Serbinë.

Para 33 vjetësh, kuislingët e regjimit serbë në Kosovë thoshin ne e kemi republikën, na mungon vetëm emri.

Sot, 33 vjet më pas....

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Në emër të grupit, por realisht po e rëndoni shumë këtë pikë të rendit të ditës.

FATON TOPALLI: Para 33 vjetësh, kuislingët e regjimit serbë në Kosovë thoshin ne kemi republikën, na mungon vetëm emri.

Sot, 33 vjet më pas, ne e kemi emrin, na mungon vetëm republika.

Qindra të vrarë, mijëra të plagosur politikë dhe gjithë ata që Republikën e duan, jo si emër, por si përmbajtje, si shtet, nuk mund të jenë të kënaqur me këtë gjendje.

Në këto kushte, 33 vjet pas demonstratave të vitit 1981, kërkesa për një republikë shqiptare mbetet shumë aktuale.

KRYETARI: Ju lutem, kjo pikë e rendit të ditës të jetë pak më relaksuese, se po e rëndoni shumë. Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Zoti kryetar!

Sot do ta kemi edhe një temë shumë të rëndësishme dhe një ligj që do t'i mbroj të drejtat e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por këtu dola për të theksuar diçka që nuk po zbatohet deri më tani nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga kryeministri Hashim Thaçi, i cili në vazhdimësi merr vendime edhe të paligjshme, edhe atëherë kur janë obligim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i përvetëson, ndërsa rezolutat e nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i zbaton, e që e ka obligim t'i zbatojë.

Është fjala për rezolutën për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, rezolutë e nxjerrë më 6 qershor 2013. Nga 10 pikat e nxjerra në këtë rezolutë nga ky Parlament, kryeministri nuk i ka parë të arsyeshme asnjë nga detyrat që i ka marrë nga Parlamenti t'i zbatojë dhe kjo vërtet është e pakuptueshme, sepse për vendimet tjera i bën në mënyrë të shkeljes së Kushtetutës, ligjeve, vendime të cilat krejtësisht janë të fushatës zgjedhore, ndërsa nuk i bën veprimet e duhura, të cilat i ka marrë si detyrë nga ky Parlament.

Shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit kanë pritur nga ky Parlament, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga institucionet e Kosovës që do të përmirësohet jeta e tyre, duke pasur parasysh rezolutën, e cila e obligon kryeministrin, por ai po merret me disa punë tjera këtu në Kosovë, duke bërë shkelje ligjore në vazhdimësi dhe do të doja që me këtë rast kryeministri të obligohet, së paku edhe për vota nëse e bën, por ta hapë zyrën që e ka për obligim nga rezoluta, ta hapë universitetin ose të ndikojë që të hapet një universitet për qytetarët e kësaj pjese dhe po ashtu të obligohet në mbrojtjen e të drejtave të tyre që i ka marrë nga Parlamenti i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: I nderuar kryetar!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që ta përshëndes vendimin e Qeverisë për lirimin e pagesës së semestrit për studime bachelor dhe master, kërkesë të cilën e pata bërë unë para dy apo tri seancave këtu, kur iu pata drejtuar Qeverisë dhe e pata kërkuar kë lirim.

Gjithashtu kërkoj që Qeveria edhe sot ta ketë parasysh këtë kërkesë timen, të cilën do ta shtroj dhe e cila është mjaft serioze. Pra, sot e mora fjalën për ta ngritur një shqetësim, i cili besoj që ju shqetëson edhe juve. Ditë më parë, debatuam për një problem mjaft të madh - për sigurinë në shkolla, vrasjen dhe dhunën e shkaktuar ndërmjet fëmijëve, veprime të cilat janë të shtyra nga shumë faktorë, nga mosha, moskontrollimi i duhur prindëror, moskujdesi i duhur i organeve kompetente, objektet e lojërave të fatit afër shkollave, përdorimi i drogës, shfletimi i faqeve me përmbajtje pornografike dhe të tjera. Fatkeqësisht, të gjitha janë realitet.

Interneti është bërë pjesë e pandashme e jetës sonë, e të rriturve dhe fëmijëve, mirëpo ekziston një numër i madh i rreziqeve potenciale që e rrezikojnë privatësinë dhe sigurinë e shfrytëzuesve të tij, veçanërisht privatësinë dhe sigurinë e fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre.

Në moshën digjitale, çdo fëmijë është vetëm një klik larg nga pornografia e turpshme, grabitqarët dhe kërcënimet e tjera, që janë gjithashtu duke u përhapur me të madhe në botën online. Asnjë fëmijë nuk është imun ndaj këtyre rreziqeve në internet. Prindërit, edukatorët dhe të rriturit e tjerë janë vija e parë e mbrojtjes kundër kërcënimeve online.

Për fat të keq, shumë prindër janë të painformuar ose nuk janë të pajisur mirë me dituri për të t'u marrë me çështjet e sigurisë në internet dhe kanë nevojë për ndihmë të besueshme nga jashtë. Këtë të hënë, më 31 mars 2014, u publikua një raport nga Qendra për Studimet e Avancuara, e cila paraqiti të dhëna tejet shqetësuese. 84% e fëmijëve nga mosha 9 deri në 16 vjeç në Kosovë kanë llogari në rrjete sociale, ndërsa 88% e tyre kanë deklaruar se kanë parë përmbajtje pornografike në 12 muajt e fundit, prej të cilëve 20% kanë parë çdo ditë ose gati çdo ditë.

Ky hulumtim është realizuar gjatë muajve shkurt-mars të këtij viti. Hulumtimi ka përfshirë 1 153 respondentë në komunat Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe janë përfshirë nxënës të 7 shkollave. Këto janë fakte shqetësuese për shoqërinë tonë kosovare, meqë 42% e fëmijëve kanë deklaruar që përmbajtja pornografike që e kanë parë në internet i ka shqetësuar ata.

Çfarë shoqërie jemi duke dashur të ndërtojmë? Çfarë ardhmërie presim për vendin tonë? Çfarë janë duke bërë prindërit? Ç'është duke bërë shteti që të rinjtë të mos u ekspozohen këtyre veprimeve? Fatkeqësisht, asgjë!

Nëse e dëshirojnë një rini të shëndosh, e cila do të formojë një familje të shëndoshë, dhe rrjedhimisht do të punojë për një shtet të fortë dhe të drejtë, shteti duhet t'i censurojë

faqet me përmbajtje pornografike në krejt Kosovën. Pornografia e ka një ndikim negativ në shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve. Është një falsifikues për dashuri erotike dhe intimitet. Ruan imazhe që nuk mund të fshihen asnjëherë. E ndihmon agresionin seksual, mund të çojë në mishërim. Mund të çojë në rritjen e egërsisë. Mund të shkaktojë ose nxis përdhunim. Presoni mund të vuajë nga skizofrenia. Mund të vijë edhe deri te vetëvrasje dhe të tjera.

Aktualisht, parandalimi shihet si arma më e fortë kundër këtij fenomeni. Si njëra ndër format më efikase të parandalimit është edukimi. Pra, edukimi në familje, në shkollë, në shoqëri dhe nëpërmjet medieve elektronike, televizion, radio, gazeta e tjera. Ky problem mund të zgjidhet shumë lehtë nëse ka vullnet nga organet qeveritare, duke bërë vetë veprimin, apo duke i obliguar kompanitë e ofrimit të shërbimit të internetit që t'i bllokojnë të gjitha faqet me përmbajtje pornografike, duke e vendosur një filtër në serverin kah shpërndahet interneti, apo Qeveria ta blejë një softuer inteligjent, i cili i bllokoi këto faqe dhe ta shpërndajë falas për të gjitha familjet kosovare.

Kontrolli inteligjent i internetit do të çonte deri te neutralizimi i pasojave negative, ndërsa anët pozitive do të mbeteshin në dispozicion. Është e nevojshme që të rregullohet me legjislacion që ofruesit e shërbimeve të internetit të kenë paketa filtri, paketa të mbrojtjes së fëmijëve falas për prindërit dhe familjet shqiptare.

Gjithashtu edhe internet-kafetë duhet monitorohen. Mbetet që shteti ynë të punojë që të zgjidhet ky problem. Fëmijët dhe çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë të ndihet i sigurt...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Mund të jetë vetëm një person me emrin Kujtim Dervishaj, por rasti i tij kurrsesi nuk është i vetëm dhe përkundër asaj që të njëjta, këto raste përfundojnë në mënyra të ndryshme. Disa me shpërbërje të familjeve, disa me probleme të shumta brenda tyre, e disa të tjera tragjikisht - me vetëvrasje.

Është fjala për veteranët e luftës së fundit në rajon. Kujtimi përveç veteran, është edhe i plagosur në luftë. Për më tepër, është i papunë dhe në një gjendje të pamëshirshme të rëndë ekonomike, por as kjo nuk i ka ndihmuar atij që të trajtohet si rast i veçantë.

Ç'është e vërteta, për ironi, trajtim i veçantë i është bërë, por në kuptimin negativ. Ai, me gjithë faktin që i përket kësaj kategorie, është përjashtuar nga mundësia që ta gëzojë pensionin invalidor, për dallim nga disa të tjerë. Kujtimi e ka kërkuar të drejtën e tij në institucionet përgjegjëse, por i është thënë se nuk ka buxhet, nuk kemi çfarë të bëjmë, gjë që nuk ka ndodhur edhe me të pushtetshmit, të cilët i takojnë të të njëjtës kategori për nga statusi ligjor, por jo edhe për nga ai ekonomik.

Ne 4 euro, pa e vrarë fare mendjen, i shpenzojmë çdo ditë me kënaqësi për t'i qerasur miqtë tanë me kafe, por Kujtimin 4 eurot që nuk i ka, e të kërkuara nga vajza e tij, siç thotë ai për t'i paguar kiflet që i marrin në shkollë, i shkaktojnë dhembje të rëndë shpirtërore deri në trishtim. Këto 4 euro dhe disa të tjera për nevojat elementare, e kanë sjellë atë deri në atë pikë sa të pendohet edhe për krijimin e familjes, e cila është i vetmi motiv i tij kundër vetëvrasjes.

Imagjinojeni për pak sekonda, të nderuar, se si mund të ndihet një njeri, të cilit i përdhohet dinjiteti deri në këtë shkallë, e megjithatë për shkak të 4 fëmijëve të tij është i detyruar të mos dorëzohet. Ne rëndom pikëllohem kur njerëzit tanë pas vdekjes i dërgojmë në varr, por nuk brengosemi për këta njerëz që varr e kanë tërë jetën, edhe me fajin tonë. Për fëmijët e tyre që vetë jetën e fillojnë nga hiçi dhe e vazhdojnë në harresë, sepse askush nuk i bënë hesap për të gjallë.

Një përbuzje e tillë, zonja dhe zotërinj, është shumë e rrezikshme për një shoqëri. Ky është demotivim për shpirtin e tij të sakrificës, që është gjithmonë burim i ndryshimeve pozitive. Si e tillë, kjo sjellje është edhe formë e edukimit për qytetarët. Në këtë mënyrë ne nuk rritim qytetarë që do ta duan vendin e vet, e do të përpiqen për të mirën e tij, sepse kjo do ta kujtonte rrëfimin e hidhur të Kujtimin, por qytetarë që përpiqen ta zhvatin shtetin, sepse kjo t'ua kujtonte jetën e ëmbël të përfituesve të pamoralshëm.

Sot pritet të miratohet Ligji për veteranët dhe shpresoj që të mirat që pritet t'i gëzojë Kujtimi si veteran të mos e kenë fatin e të mirave që do të duhej t'i gëzonte ai si invalid. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

**HALIT KRASNIQI:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,  
Të Parlamentit të Kosovës,  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar ministra,

Sot do ta përsëris një shqetësim nga komuna ime prej nga vij, nga Malisheva, të cilin shqetësim përafërsisht nja 20 herë e kam ngritur këtu në këto 3 vjet, por që aktualisht me këto ndryshime klimatike tani që kanë ndodhur në planet dhe në vendin tonë, këto shqetësime që i kam ngritur kanë filluar të lajmërohen dhe e kam fjalën për ethet hemorragjike, që këtë vit kanë filluar të vijnë para kohës së viteve tjera.

Në këtë kohë, aktualisht qindra qytetarë janë prekur nga ethet hemorragjike dhe vetëm në fshatin tim të lindjes, në Drenoc të Malishevës, janë rreth 60 raste dhe gjithashtu qindra raste në komunën e Malishevës të lajmëruara në ambulancën e qytetit dhe për pasojë ato shqetësime janë trajtuar në mënyrën e vjetër, sikur përpara në vitet tjera.

E di që Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë kanë program dhe janë deklaruar ministri dhe kryeministri në këtë Kuvend për mbështetje të qytetarëve të Malishevës dhe e kanë deklaruar shqetësimin e tyre për këtë dukuri dhe pasojat e saj.

Unë edhe një herë nga këtu apeloj te Qeveria dhe te të gjithë mekanizmat që janë relevantë dhe që u takon të merren me këtë shqetësim: është koha e fundit kur të gjithë mekanizmat qeveritarë, të gjitha programet që duhet të aplikohen, të vihen në veprim dhe të mos mbeten sikur vitin e kaluar që të reagojnë pastaj kur të fillojnë vdekjet një pas një.

Unë për veten time e lus Zotin dhe kërkoj nga ju që ky shqetësim për herë të fundit të shtrohet në Kuvendin e Kosovës dhe masat në veprim të jenë të efektshme, ashtu siç i ka paraparë Qeveria me programin e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja që unë dua të ngre lidhet me disa zhvillime në arenën ndërkombëtare të kohëve të fundit, e ku Kosova po përmendet dhe keqpërdoret gjithnjë e më shumë. E kam fjalën për krahasimin e aneksimit të Krimesë nga Rusia me rastin e Kosovës.

Ky Kuvend nuk ka folur asnjëherë deri më tani për këtë çështje dhe ky indiferentizëm mua personalisht më pengon. Në fakt, kjo është një çështje që i ka përfshirë të gjitha ata diplomatë që janë marrë me menaxhimin e çlirimit të Kosovës dhe me menaxhimin e shpalljes së pavarësisë.

Për këtë çështje ka reaguar edhe vetë presidenti Obama. E kam parë pasiv edhe ministrin e Jashtëm që është drejtpërdrejt përgjegjës për t'i mbrojtur interesat e Kosovës në arenën ndërkombëtare. E çuditshme, por ministri Hoxhaj ka folur pas të tjerëve, kurse do të duhej të fliste i pari.

Është për të të ardhur keq pse shteti i Kosovës është shumë i ngathtë në krijimin e opinionit ndërkombëtar, edhe pse ka në duar të vërteta të mëdha dhe të pakontestueshme.

Sado që kjo është një çështje përtej nesh, Kosova është subjekt i saj dhe ndaj duhet të reagonim. Ministri i Jashtëm i Kosovës duhej t'i kujtonte Rosisë dhe mbarë opinionit ndërkombëtar së ligjshmërinë e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës e ka njohur edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, pra institucioni i OKB-së.

GJND-ja shprehimisht ka thënë se nuk është shkelje e të drejtës ndërkombëtare shpallja e pavarësisë nga ana e popullit të Kosovës, e kjo është një certifikatë ndërkombëtare që Ministria e Jashtme duhet ta përmend sa më shpesh.

Ministri do të duhej të ishte i pari, në fakt, në dhënien e argumenteve diplomatike dhe historike se si Krimeja dhe Kosova janë dy raste që dallojnë si dita me natën.

I pari dallim është se ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte ndërhyrje për shkaqe humanitare, pasi regjimi i Serbisë shkelte me të madhe të drejtat e njeriut, duke bërë tentativa për gjenocid, spastrim etnik, vrasje, dhunime, e tjerë.

I dyti dallim i madh është se Serbia e aneksoi me dhunë Kosovën, njëherë më 1912 e po kështu edhe në '45-ën dhe se populli shqiptari i Kosovës iu nënshtrua për një shekull dhunës, spastrimit etnik dhe diskriminimit.

Por, në anën tjetër, dua të tërheq vëmendjen tuaj si deputet, por edhe të mbarë opinionit publik, në lidhje me një gjë të rëndësishme, se aspak nuk ka qenë e lehtë për SHBA-në dhe Evropën, të ndërmarrin hapin e guximshëm të ndërhyrjes ushtarake.

Të hedhim një vështrim në hartën e botës sot dhe do të shohim vende që po mbyten në gjak dhe bashkësia ndërkombëtare nuk po mundet të ndërhyjë për t'i shpëtuar këta popuj për shkak të mospajtimeve ndërmjet fuqive të mëdha.

Në këtë kontekst, çdo shqiptar duhet të vlerësojë edhe më shumë lirinë që gëzon sot Kosova. Përshtypja ime është se një pjesë e njerëzve kanë filluar ta harrojnë këtë. Madje, ka një dozë të antiamerikanizmit që po rritet. Naiviteti i disave dhe djallëzia e atyre që po punojnë ku ndër Kosovës është kombinim fatal.

Nga ana tjetër, njerëzit që qeverisin këtë vend, përditë e më shumë po i zhgënjëjnë çlirimtarët. Krimi, korrupsioni, paaftësia, papërgjegjshmëria...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Faleminderit! Por, në Kosovë nuk ka antiamerikanizëm kurrkund, prandaj kur t'i trajtojmë temat, trajtoni në përgjegjësinë e deputetit dhe të foltores. Nuk është Parlamenti, veç të flasim fjalë të mëdha.

Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, nuk e pata në plan të flas, por në vazhden e përshëndetjeve për vendimet e Qeverisë, unë nuk kam përshëndetje dhe çuditë që si deputetët e Kuvendit të Kosovës, duke provuar që në fakt të fitojnë mbështetjen, qoftë edhe të partive të tyre ose popullaritetin e kujt do qoftë tjetër, përkrahnin vendimet e kryeministrit, i cili totalisht ka humbur arsyen.

Nëse asgjë nuk kuptojmë, ne e dimë që të gjitha vendimet e fundit po bëhen për vota, janë komplet politike. Edhe vendimi i fundit për lirimin e pagesave të semestrit dhe pagesave të tjera të studentëve në universitetet publike është komplet politik dhe një gjë të tillë e kanë marrë vesh të gjithë studentët. Ata në fakt, u deklaruan dje edhe publikisht.

Ky është fillimisht vendim autoritar. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, thanë që nuk janë konsultuar fare lidhur me këtë dhe kryeministri duhet ta dijë që këto janë të hyra vetjake të Universitetit të Prishtinës.

Tjetra është, kjo është një kërkesë që studentët e kanë bërë që sa kohë dhe nuk është dashur të pritët deri në kohë të fushatës. Nëse, kryeministër, nuk e dini, afati i fundit për

regjistrimin e semestrit të dytë të këtij viti akademik ka qenë 28 marsi i këtij viti, domethënë e premtja e kaluar dhe të gjithë tanimë e kanë të paguar semestrin e dytë të këtij viti akademik. Vendimi juaj, që e morët dje hyn në fuqi më 1 maj dhe studentët rrinë në konvikte deri në 1 qershor, do të thotë, ju keni bërë lirim të pagesave për një muaj.

Në fakt, ne duhet, ju kryeministër, nuk e keni luksin më që të blini votat e qytetarëve, as me veprime dhe as me vendime, sepse qytetarët e Kosovës janë vetëdijesuar mirë shumë dhe ata do e shohin punën që keni bërë gjatë këtyre dy mandateve dhe jo vetëm gjatë dy muajve të fundit.

Në vitin 2010 keni premtuar punësim, rritje ekonomike, investime të huaja. Çka ka ndodhur? Investimet e huaja në vitin 2007 kanë qenë 440 milionë, investimet e huaja në vitin 2013 kanë rënë në 260 milionë. Deficiti tregtar ka qenë, kur e keni marrë mandatin e dytë 1,8 miliard, deficiti tregtar sot është 2,2 miliardë.

Sipas Bankës Botërore janë 200 mijë qytetarë të Kosovës, që jetojnë në varfëri ekstreme dhe janë rreth 600 mijë të tjerë që jetojnë me 1,7 euro në ditë.

Në vitin 2010, kryeministër, keni premtuar liberalizim të vizave për 15 muaj, sot ne nuk lëvizim të lirë dhe fajet nuk i ka Brukseli, siç thoni ju, po i ka në fakt korrupsioni i lartë deri tek tenderi i pasaportave, vjedhjet në dhomat e dëshmime në Pejë dhe Prishtinë...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

**KRYETARI:** Do të thotë nuk kemi të paraqitur, koha është harxhuar për këtë pikë. Kryeministër, ju lutem pritni pak! Kryeministër, thashë pritni pak.

Jo, unë dua t'i them dy-tri fjalë, për faktin se po ngritën disa çështje këtu që nuk e kanë ndoshta vendin në rend të ditës. Por, unë dua të them që shqiptarët e Kosovës, qytetarët e Kosovës dhe shqiptarët në përgjithësi, janë njerëzit që më së shumti i janë mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha vendeve që e kanë mbështetur luftën e drejtë dhe çlirimtare të popullit të Kosovës.

Në këtë drejtim, mendoj që jam i bindur, që nuk ka vend dhe shtet në botë, që e respekton dhe e vlerëson, i vlerëson politikat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dhe, çdo përpjekje për të qitur qytetarët e Kosovës dhe shqiptarët në një kontekst tjetër, mendoj është politikë e gabuar dhe nuk duhet ta reflektojë jo vetëm në Kuvend, por mendoj që as jashtë Kuvendit.

Për diskutim jashtë rendit të ditës nga ana e Qeverisë, janë kryeministri dhe ministri i Shëndetësisë. Kryeministër, e ke fjalën.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë nuk dëshiroj që të hyj me secilin deputet në sqarime, që u drejtuan Qeverisë, por dëshiroj që të jap sqarimin e drejtë dhe në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë dhe të përgjegjshme për qëndrimin që prezantoi Hykmetja në emër të Lidhjes Demokratike të

Kosovës, për mos zvogëlimin e pagesës së studentëve për 50%, për lirim do të thotë për semestra, për pagesën e semestrave, për banim në konvikte, gjithashtu lirim që e kemi marrë vendimin për 50%, si dhe për ushqimin e studentëve në mensë për 50%, për këta 60 mijë studentë.

Po, është e vërtetë, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për lirim të të gjithë studentëve për 50% pra, për semestra, lirim për 50% për të gjithë studentët me banim në konvikte, lirim për 50%, lirim për 50% për të gjithë studentët që ushqehen në mensën e tyre. Gjithashtu, për me të plotësua, Hykmete, uroj që ju nuk e forconi kundërshtimin tuaj ndaj këtij vendimi të Qeverisë për lirim të studentëve nga pagesa, të gjithë brucoshët nga ky vit regjistrimin në vitin e parë do ta kenë gratis, pra këta 60 mijë studentë të Universitetit të Prishtinës.

Ndërsa, unë ju ftoj edhe juve për një vetë përgjegjësi, sepse ky vendim për lirim nga pagesat e studentëve është marrë pasi që janë rritur pagat të gjithë profesorëve universitar, duke përfshirë edhe juve, e nderuara zonja Hykmete, shumë e respektuara dhe e nderuara.

*(Ndërprerje e incizimit.)*

KRYETARI: Po, deputete, ke të drejtë. Deri në tre minuta e ke të drejtën e fjalës. Deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BJARAMI: Faleminderit, shumë kryeministër, qysh një herë nuk mujte me qenë i sinqertë. Nuk thashë që jam kundër, nuk fola në emër të LDK-së, fola në emrin tim personal, e para.

Të lutem, të jesh më i vëmendshëm, sepse nuk mundesh në të njëjtën kohë edhe të flasësh në telefon edhe t'i dëgjosh deputetët çka flasin. Absolutisht, domethënë je kundër. Unë prita që po më jep ndonjë përgjigje lidhur me autostradën, se zakonisht përgjigjet tua çfarëdo që të pyesim janë ashtu. Nuk jam kundër. E keni marrë në kohë të fushatës vendimin. Ju lutem, shumë.

Asnjë prej vendimeve që keni marrë dy muajt e fundit, nuk i keni pasur në konsideratë gjatë këtij mandati. Ju dje keni marrë edhe një vendim tjetër, t'i lironi nga taksa personat me aftësi të kufizuar, nga taksa për nxjerrjen e pasaportës, letërnjoftimit dhe patentë-shoferit.

A nuk e keni ditur që 4 vjet që ekzistojnë këta persona, a nuk e keni ditur gjendjen e tyre financiare?

Keni marrë edhe një vendim tjetër, keni dhënë 150 mijë euro për strehimoren. Deputetja Donika Kadaj gjatë amendamentimit të buxhetit të vitit 2014 ka sjell amendament, janë deputetët e partisë tënde që nuk e kanë përkrahur një amendament të tillë. Dhe, ju shkoni, sot keni marrë buxhetin nën sqetull, duhet t'ju vijë turp dhe e shpërndani për të blerë vota.

KRYETARI: Kryeministri, replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Hykmete, së paku ju po dalloni nga deputetët e LDK-së, sepse këta janë më të relaksuar pak, zakonisht në diskutime e në komunikim. E ka dashur edhe koha edhe nevoja që edhe ju të adaptoheni me logjikën e komunikimit më të civilizuar dhe më të kultivuar, e jo me bërtima, por unë s'ju kuptoj, kur i rrisim rrogat për të gjithë punëtorët e Kosovës, ju dilni kundër, bile me zë.

Kur ne marrim vendim për rritjen e pagave për minatorët, ju dilni kundër. Kur ne marrim vendim për rritjen e pagave për të gjithë punëtorët në Korporatën Energjetike të Kosovës, ju dilni kundër. Kur ne marrim vendim për uljen e pagesës për të gjithë studentët e universiteteve publike në Republikën e Kosovës, ju dilni kundër.

Unë vetëm mund t'ju them se nuk jeni duke e nderuar as Lidhjen Demokratike të Kosovës, me këtë qëndrim që po flisni në emër të LDK-së, që po i bëni këto refuzime.

*(Ndërprerje e incizimit.)*

KRYETARI: Kryeministri po e vazhdon. Urdhëro!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Deri më tani, po për autostradën, shumë mirë. Ne në përrurimin e autostradës kemi qenë së bashku. Jo, s'e ka prishë kurrkush, atë nuk mund ta prishë kurrkush hiç.

Tash, unë vetëm mund t'ju ftoj juve në fillimin, në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të autostradës tjetër, që do të ndodhë në ditët e ardhshme prej Prishtinë në drejtim të Shkupit, natyrisht me projektin e ri nga Ferizaj në drejtim të Vitisë, Gjilanit deri Dheu i Bardhë në Preshevë. Faleminderit, shumë!

*(Ndërprerje e incizimit.)*

KRYETARI: Mirë, replikë deputetja Hykmete Bajrami. Një minutë!

HYKMETE BAJRAMI: Kryeministër, prapë nuk ishe i singertë. Nuk kemi qenë kundër, as për ngritje të pagave, as për asnjë vendim tëndin, vetëm kemi kontestuar kohën, kur e keni marrë vendimin në kohë fushate.

Të lutem shumë, a ke mundësi për të më treguar në cilin nen, në cilin ligj je thirr kur ke shkuar dhe i ke rritur pagat e Korporatës Energjetike të Kosovës, sepse ata janë ndërmarrje publike dhe nuk shkon kryeministri ndërmarrjeve publike për t'ua rritur pagat.

Edhe s'kam dyshim që ke me e pre edhe ndonjë shirit gjatë kësaj fushate, por më trego a me tenderin e 500 milionë apo me atë 600 milionë, me tunel apo pa tunel?

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Hykmete, ju po tregoni se nuk i keni as njohuritë elementare të projektit të autostradës Prishtinë-Shkup, as me tunel as pa tunel, as me ura as pa ura, as me këmbë të urave, as pa këmbë.

Po, është e vërtetë dhe ndihem shumë mirë dhe qëndroj pas propozimit tim që e kam dhënë në Korporatën Energjetike të Kosovës, për rritjen e pagave për të gjithë punëtorët, rreth 5 mijë punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës. Një herë propozimi ka qenë për një shumë modeste, propozimi im ka qenë për bordin dhe menaxhmentin, 120 euro. Qëndroj pas atij propozimi, vendimi është i Korporatës, propozimi im është legal, legjitim, kushtetues dhe ligjor. Por, unë ju ftoj, kuptoni edhe ata që punojnë atje, mos dilni kundër kështu që nuk po i bëni nderë as vetvetes e as partisë që po flisni në emër të saj dhe po e fuqizoni këtë kundërshtim.

Në anën tjetër pasi që po kërkon sinqeritet, unë isha 100% i sinqertë. Unë e kam një pyetje për ju, e di se nuk është kjo kohë tash e deklarimeve tjera për pyetje, por për hir të opinionit - a ka mundësi ju personalisht si profesoreshë të vini këtu ku jam unë dhe t'i tregoni qytetarëve, më së pari deputetëve këtu, pastaj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, ama t'iu tregoni sinqerisht sa herë prej së qeveris unë u është rritur paga juve personalisht si profesoreshë, pastaj fol kundër uljes së çmimeve për studentë në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Unë ju ftoj sepse e keni obligim moral, pasi që po kërkon sinqeritet maksimal, si më e sinqerta e Parlamentit dhe më e zhurshmja, edhe unë kërkoj prej juve një sinqeritet maksimal, përndryshe përgjigjen e di edhe profesor Hamiti. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, ju lutem deputete, i ke harxhuar fjalët tua! Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Kërkesa jote për relaks na erdhi kështu pak papritur, por qe tash, shkoi kryeministri, shyqyr që shkoi, e vazhdojmë me Ligjin për veteranët e ligjet shumë të rëndësishme, e faleminderit për këtë relaks. Kryeministri na relaksoi pak edhe shkoi. Rruga e mbarë, shkoftë e mos u ktheftë! Hajde, mirupafshim!

*(Ndërhyrje)*

*(Ndërprerje e incizimit.)*

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Unë për Rregullore e kam fjalën, meqë ajo rubrikë në të cilën u fol këtu është e diferencuar, kush flet në emër grupi që i ka 5 minuta, kush flet individualisht i ka 3.

Duhet të jeni korrekt edhe ju kur e udhëhiqni edhe mua më ndodh të jem atje ndonjëherë, që nëse i prehet njeriut fjala sepse i ka të vetat si deputet 3 minuta, mos të krijohet dialogu që flet në emër të grupit, qoftë pse s'i ka edhe 2 minutat e veta.

Ju po më kuptoni çka po them. Për të pasur një komunikim të vërtetë publik, të dihet, të thuhet, nëse i replikohet 1 deputeti, i replikohet 1 deputeti, jo një grupi, sepse nëse jo për tjetër, ai deputet s'i ka marrë 5 minutat e grupit. Kaq.

**KRYETARI:** Faleminderit, nënkryetar! Po fjalët e deputetëve që janë përfunduar dhe ju e dini që me nenin 48 të Rregullores, Qeveria e ka edhe ajo kohën e vet dhe sa herë flet Qeveria, që nga një herë pozita nuk e kupton, deputetët kanë të drejtë në deklaratimet e tyre deri në 3 minuta. Dhe, unë e kam respektuar pikë për pikë Rregulloren e Kuvendit. Kështu që në këtë rrafsh, jemi shumë mirë.

Prandaj, edhe Teuta e ka fjalën për këtë çështje, mund ta merr fjalën tani dhe tani e ke rendin Teutë, se nuk ke pasur rendin më herët. Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Më mirë vonë se kurë. Unë desha ta ngre një çështje që ka të bëjë me një qytetar të komunës së Gjakovës, konkretisht...

Kryetar, kjo është çështje jashtë rendit të ditës, se ju ke kthyer prapë deputetëve.

Prandaj, kryetar, dua ta ngre një shqetësim të një qytetari nga fshati Shqiponjë e komunës së Gjakovës, qytetari është Haxhi Ramaj, i cili në momentin që ka shkuar si i sëmurë që tri vite, në momentin që ka shkuar ta marrë pensionin e pleqërisë me një aktvendim të lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjakovës, i ndalet 1/3 e pensionit, pra mjeteve materiale të domosdoshme, e pensionit të moshës, pa marrëveshje, pa dijeninë e tij dhe unë nuk e di se si kjo Qeveri e Kosovës që merr vendime gjatë kësaj kohe që thjeshtë është edhe fushatë, nuk mendon asnjëherë për një kategori të shoqërisë, kategori më të ndjeshme që janë pensionistët duke i plaçkitur edhe kompania e KEDS-it pra, u ndalë për borxhet e vjetra që i kanë pasur në KEK duke ditur se me asnjë të punësuar nuk mendon asnjëherë kjo Qeveri se sa anëtarë të familjes mund të mbahen me 60 euro dhe sot pra plaçkiten në mënyrë të fshehurazi dhe gjithashtu u ndalen edhe mjetet në qoftë se nuk lajmërohen vetëm një ditë, në qoftë se u kalon afati pas vërtetimit se ata janë gjallë prapë u ndalen ato mjete dhe as sot e kësaj dite as ne nuk e dimë se ku shkojnë ato mjete, por sigurisht se keqpërdoren dhe nuk dihet pra dhe qytetari asnjëherë nuk mundet të marrë informatën se ku shkojnë ato mjete.

Pra, me një fjalë në qoftë se pensionet e moshës janë mjete të domosdoshme, unë konsideroj se ndalja e pagesës pa dijeninë e qytetarëve është një shkelje elementare e të drejtave të njeriut, prandaj është një shqetësim që duhet të mendojë edhe kjo Qeveri edhe për këtë kategori shumë të ndjeshme të shoqërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, unë po kërkoj nga deputetët të jeni më të vëmendshëm. Pika e rendit të ditës - deklarime jashtë rendit të ditës për deputetët ka përfunduar para se kryeministri ta marrë fjalën.

Me marrjen e Qeverisë është deklarimi i Qeverisë dhe mund deputetët të replikojnë dhe të debatojnë deri në 3 minuta, në fjalën e kryeministrit, por jo ta përsërisin fjalën e vet që s'kanë mund ta shfrytëzojnë më herët, prandaj po kërkoj që të jeni më të vëmendshëm që ta dimë këtë renditje.

Koha ka qenë 30 minuta dhe është shfrytëzuar për deputetët 30 minuta. Ne kemi votuar si Kuvend 30 minuta dhe nuk ka kohë më shumë se 30 minuta. Po kërkoj që t'i respektoni këtë rend dite që e kemi miratuar në Kuvend.

Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, zoti Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Demolli,

Një informatë përkitazi me gjendjen e shërbimeve të kujdesit intensiv në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë ka qenë e përkushtuar në vazhdimësi që të ngritën këto kapacitete, vështirësitë janë evidente, disa prej tyre i përshkruat. Përpjekjet janë të jashtëzakonshme që të ngritët përgjegjësia menaxheriale në këtë repart, i cili përfundimisht i reflekton rrethanat e gjendjes emergjente të pasluftës dhe përpjekjeve që brenda kapaciteteve ekzistuese të ngritët cilësia e shërbimeve që është e pamundur.

Atë që kemi bërë dhe kemi arritur ta bëjmë është që të përpilojmë planin detal të repartit të ri të kujdesit intensiv në katin 3 të Qendrës Diagnostiko, në hapësirat ku ka qenë Qendra e Transfuzionit të Kosovës, e cila ka dalë në objekt të ri, në këto hapësira do të ndërtohet brenda 3 muajve të ardhshëm, Kujdesi Intensiv Emergjent i cili do të ketë 26 shtretër, me 26 respiratorë, me të gjitha aparaturat e nevojshme për ofrimin e shërbimit të kujdesit intensiv.

Ky projekt është duke u zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Turqisë. Nga ana tjetër, kemi arritur që në kornizën afatmesme të shpenzimeve ta vendosim projektin 30 milionë euro të Qendrës Emergjente Universitare, për të cilën e kemi siguruar konstruksionin financiar për mbështetje nga ana e 3 agjencive investive, Bankës Islamike për Zhvillim, Fondin Saudit për Zhvillim dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillim. Dhe, kjo pritet po ashtu që të rumbullakohet ky konstruksion gjatë 3 muajve të ardhshëm, ndërsa në buxhetin e vitit 2014 kemi 0,84 milion euro për fillimin e punëve në këtë qendër sivjet.

Ndërsa, për deputetin Krasniqi, në qoftë se mund ta informoj se Këshilli Ndërmënytor për ballafaqimin me ethe hemorragjike është duke e përcjell situatën në baza ditore. Deri më tani janë gjithsej 63 pickime nga ana e rriqrave, asnjëri prej rasteve nuk është pozitiv. Më 7 prill, në Malishevë e shënojmë Ditën Botërore të Shëndetësisë, e cila këtë vit u është dedikuar sëmundjeve që barten me vektor dhe do të jetë rast i mirë që edhe një herë të kontribuojmë për rritjen e vetëdijes së qytetarëve në atë rajon dhe organizimin më të mirë të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që duhet reagu.

Të jeni të bindur se sivjet përgjigja institucionale në këtë situatë do të jetë maksimale dhe asnjëherë më e mirë . Faleminderit!

KRYETARI: Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!  
Ma përmendi emrin. Faleminderit, zoti ministër...

KRYETARI: Ramiz Lladrovci, lexoje nenin 48 të Rregullores. Nëse nuk e lexon, atëherë mos fol!

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!  
Faleminderit i nderuar ministër i Shëndetësisë,  
Unë si deputet vetëm e ngrita shqetësimin e qytetarëve se vërtet mu drejtuan me këto fjalë. U mundova ta bëj një përshkrim sa më të saktë për gjendjen aktuale të Repartit të Intensives, jo të Emergjencës, por të Intensives. Madje, madje edhe mjekët në atë repart, sepse fatkeqësisht këto ditë kam pasur mjaft kontakte me ta, edhe mjekët kërkuan që këtë çështje ta ngri si çështje në këtë Kuvend.

Më vjen mirë për informatat që ju i paraqitët këtu para nesh dhe para opinionit publik dhe shpresoj që ju t'i mbani këto fjalë dhe për një afat sa më të shkurtër kohor të kalohet në repartin tjetër, respektivisht në hapësirën tjetër të ndërtesës e aq më parë do të isha shumë i kënaqur sikur të gjithë ata pacientë të cilët janë të shtruar, sepse edhe ju vetë ishit pjesëmarrës në varrimin e doktor Fatonit, gruaja e të cilit për një qëndrim shtatë mujor të tij ka paguar 23 mijë euro. Po i flas fjalët e saj.

Prandaj, mirë është që ne si shoqëri të kujdesemi të paktën për këta persona të cilët janë në një gjendje shumë të rëndë shëndetësore që sa i përket medikamenteve dhe pajisjeve medicinale të mos vuajmë, ne t'i heqim shpenzimet për to, kurse të tjerët që janë në gjendje më të mirë disi të gjenden. Faleminderit!

KRYETARI: Prit, se e kemi edhe Halitin që ia ka përmendur emrin. Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës!  
Faleminderit, ministër për fjalët dhe programin që e keni bërë për Malishevën,

por programe dhe iniciativa, edhe intervenime ka pasur edhe viteve tjera. Po, vdekjet nuk janë parandaluar. Ajo çka është më e keqja, shqetësimet që kanë familjet kur atakohen nga ethet hemorragjike janë shumë të mëdha.

Me këtë rast, tash mbi 54, afër 54 janë vetëm në vendlindjen time tash aktualisht, 2 janë Domanek, gjithsej në Malishevë shkon te 63.

Por, tani asnjëri, falë kësaj që thoni ju, nuk është në rrezik jete, por shqetësimet janë njësoj, sepse hija e vdekjes shetit nëpër këto familje dhe asnjëri nuk është i sigurt se si do të vjen fundi i tij, kështu që shqetësimet janë të papërshkrueshme.

Ju lutem që të merrni masa dhe kështu më 7 prill ne ta heqim një brengë të cilën e kemi me vite pas luftës në Malishevë.

Tani unë shpresoj shumë në projektet që i ka bërë Qeveria, shpresoj në përkushtimin tuaj dhe e vlerësoj jashtëzakonisht shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Vetëm një informatë përkitazi me shpenzimet për të sëmurët që trajtohen në Kujdesin Intensiv, po jo vetëm në Kujdes Intensiv, por edhe në njësi tjetra të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Ministria e Shëndetësisë e ka rregulluar këtë çështje me akt nënligjor, me udhëzim administrativ i cili mundëson që të gjitha ato barna, material harxhues që nuk është në gjendje Qendra Klinike Universitare e Kosovës për t'u ofruar pacientëve në repartin e Kujdesit Intensiv, të mbulohen shpenzimet nga Fondi për trajtimin jashtë institucioneve publike shëndetësore. Dhe, kemi raste të tilla, nuk e di rastin konkret, por kemi raste përfundimisht që janë kompensuar për shpenzime të cilat i kanë bartur familjarët për pacientët e shtrirë në Repartin e Kujdesit Intensiv.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Po ju njoftoj që një pjesë e ministrave janë këtu, por pjesa më e madhe nuk janë. Ndoshta ka qenë mirë për ta zhvendosur këtë pikë të rendit të ditës për të filluar me Ligjin për veteranët, pasi edhe veteranët i kemi këtu.

A jeni dakord? Një deklaram, kush është për ta bërë këtë? Mirë, faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

## **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj nënkryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeten Time Kadrijaj, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Unë kështu e kam të shkruar, atëherë fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të neneve 57, 58 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në disa mbledhje të mbajtura e ka shqyrtuar Projektligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2014 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### Raport

Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

Ne i kemi dërguar edhe në komisionet funksionale, të gjitha komisionet i kanë kthyer rekomandimet pa asnjë vërejtje, janë pajtue me amendamentet tona të cilat i kemi bërë.

Unë kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ta miratojnë projektligjin me amendamentet. Faleminderit!

KRYETARI: Fillojmë me votimin e amendamenteve:

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të pranishëm janë 79 deputetë.

Amendamenti 2

Është i deputetes Biserka Kostiq, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. I kemi 80 deputetë të pranishëm dhe vazhdojmë. Deputetët kush do të vijë vjen, askush nuk ua ka ndalua atyre të vijnë në seancë.

E votojmë amendamentin 2 në mënyrë elektronike, është i deputetes Biserka Kostiq, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Konstatohet se me 1 votë për, 81 kundër dhe 1 abstenim, nuk miratohet amendamenti 2, i propozuar nga deputetja Biserka Kostiq, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 3

I Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,  
Deputetë,

Nëse më lejoni, unë do ta bëj arsyetimin për amendamentet 3, 4, 5b, 6, 7 dhe 8.

KRYETARI: Amendament për amendament i arsyeton, jo përnjëherë. Kur shkojmë te amendamenti përkatës, e arsyeton. Nuk po ngutemi.

ANTON QUNI: Unë mendova vetëm për çështje të kohës. Nuk ka problem. Faleminderit!

Amendamentet e propozuara sigurojnë që të gjithë faktorët relevantë, politikë e ushtarakë për mbrojtjen e Kosovës dhe çlirimin e vendit do të trajtohen të barabartë me ligj.

Kjo siguron që të gjithë ushtarët dhe ushtarakët nën armë, të uniformuar me emblemen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të trajtohen me ligj, pa marrë parasysh nëse ishin nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm, apo të Ministrisë së Mbrojtjes.

Për më shumë, amendamentet e propozuara sigurojnë që çlirimi i Kosovës është rezultat i përbashkët i përpjekjeve, organizimeve dhe sakrificave të vazhdueshme të gjeneratave dhe shoqërisë në tërësi për mbrojtjen dhe çlirimin nga çdo formë e okupimit.

Krijimi i institucioneve të Republikës së Kosovës edhe nën kushtet e okupimit është treguesi i kulturës dhe pjekurisë sonë të shtetformimit.

Mospërfillja dhe mostrajtimi i këtyre institucioneve dhe sjellja indiferente ndaj tyre është atakim me përpjekjet e gjeneratave të tëra për Kosovën shtet të lirë, të pavarur dhe demokratik.

Kjo sjellje i vë në pikëpyetje të madhe vlerat dhe kulturën tonë të shtetformimit.

Edhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ishte një ndër institucionet e Republikës së Kosovës si faktor i rëndësishëm për mbrojtjen e popullatës dhe për çlirimin e vendit.

Prandaj, edhe duhet trajtuar krahas Shtabit të Përgjithshëm, pa e përjashtuar njëra-tjetrën.

Ne tani si përgjegjës të institucioneve të Kosovës...

KRYETARI: Ju lutem deputet, unë thashë të flasësh për amendamentin.

ANTON QUNI: Në rregull! Fjala ime lidhet për amendamentin numër 3.

Ne tani si përgjegjës të institucioneve të Kosovës po bëjmë përpjekje të mëdha dhe shumë herë të dhimbshme për të arritur kompromise në raportet Republika e Kosovës, Republika e Serbisë dhe autoritetet ndërkombëtare.

Ndër të tjera, ne pranuar që forcat ilegale paramilitare dhe paralele, të shtrira në veri të Kosovës, t'i mbrojmë me ligj dhe t'i legalizojmë brenda institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës.

Ky është çmimi i ndërtimit të marrëdhënieve të mira në raport me Serbinë.

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të jeni të bindur se nuk ka paqe me Serbinë pa u arritur paqja e brendshme. Është e pakuptueshme që formacionet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe vetë Ministria e Mbrojtjes të mbeten jashtë Ligjit për veteranët, sikur të kishin qenë formacione paramilitare dhe kriminale.

Një politikë aq humane dhe përkëdhelëse ndaj forcave paramilitare serbe dhe në të kundërtën një politikë aq e ashpër kundër formacioneve të Ministrisë së Mbrojtjes me emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me qindra dëshmorë të rënë, shumë heronj, beteja të lavdishme si vlerë e përbashkët e kombit, e ngritur mbi nevojat e kohës dhe vullnetit të popullit, është krim ndaj vetvetes dhe histori e shkruar varësisht nga politika ditore, teket dhe inatet e pakuptueshme.

Ne sot e kemi mundësinë që ta ndërtojmë paqen e brendshme. Një herë e përgjithmonë, duke e pranuar të vërtetën, t'i shuajmë të gjitha inatet, konfuzionet, hasmëritë e tjera.

Ne kemi edhe shumë punë për të bërë dhe kemi nevojë për njëri-tjetrin. Prandaj, vetëm e vërteta krijon besueshmëri dhe besim te njëri-tjetri.

Po u drejtohem të gjithë veteranëve të luftës, që tani janë deputetë.

Ne e kemi një kod të veçantë të sjelljes dhe respektin ndaj njëri-tjetrit.

Edhe pasi ta procedojmë Ligjin për veteranët, ne duhet ta shikojmë njëri-tjetrin në sy. Nderi dhe besimi janë vlera jonë. Kërkoj nga ju përkrahjen dhe ndikimin që edhe pas kësaj seance të mund ta shikojmë njëri-tjetrin në sy. Faleminderit!

**KRYETARI:** I nderuar deputetë,

Unë e kam thënë edhe më herët, ne nuk po bëjmë histori këtu, as nuk po bëjmë politikë, dhe të gjitha krahasimet që i bëre janë krahasime që nuk shkojnë dhe që nuk i ndihmojnë proceset as sot dhe as nesër. Dhe, unë po kërkoj nga deputetët e Parlamentit të Kosovës që vërtet të jenë të përgjegjshëm për çdo fjalë që e thonë.

Fjalën e ka kërkuar Rexhep Selimi.

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua ta arsyetoj votën kundër amendamentit 3 të këtij projektligji: Ky amendament do të kishte kuptim vetëm në dy rrethana. Rrethana e parë në të cilën do të kishte kuptim ky amendament është nëse Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe Ministria e Mbrojtjes do ta

kishin relacionin normal që do të duhej ta kishin Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, gjë që nuk e kanë pasur për shkak se nuk e kanë pasur si të thuash atë relacionin normal që do të duhej të kishin.

Pra, nuk i kanë raportuar njëra-tjetrës.

Dhe, situata e dytë, në të cilën do të kishte kuptim ky amendament është nëse secila prej këtyre dy organizmave, këtu Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, ta kishin nga një ushtri të vetin në terren.

Dua të konfirmoj edhe një herë që vetëm një ushtri ka qenë përballë forcave të Serbisë okupuese në këtë vend dhe ka qenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe jemi shumë të bindur që ky amendament nuk e përjashton asnjë luftëtar, i cili ka qenë i rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pavarësisht nga prejardhja e tyre politike, që nuk kanë qenë vetëm një apo dy prejardhje politike, por në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka pasur shumë burime dhe prejardhje politike si ushtarë, luftëtarë në UÇK.

E dyta, unë mendoj edhe një herë që nuk duhet t'i mohohet askujt asnjë ditë dhe asnjë hap i kontributit për lirinë dhe unë nuk do ta pranoj asnjëherë që t'i mohohet dikujt asnjë hap për lirinë e Kosovës, duke mos e mohuar as kontributin e Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë së Kosovës në egzil. Por, të mos harrojmë që jo vetëm Ministria e Mbrojtjes së Qeverisë së Kosovës në egzil, por edhe Ministria e Mbrojtjes së Qeverisë së Përkohshme, edhe Lëvizja Popullore e Kosovës, edhe Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, edhe Partia Parlamentare e Kosovës, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe Partia Republikane e Kosovës, edhe fondet financiare, qoftë brenda, qoftë jashtë territorit të Kosovës, edhe organizatat tjera, qoftë Fondi për Financim, edhe të tjera, kanë kontribuar për lirinë e Kosovës dhe kanë kontribuar në mobilizimin e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe, e fundit, të mos harrojmë, ne sot po e bëjmë një ligj për veteranët e luftës, jo një ligj për veteranët e politikës. Prandaj, po mendojmë që Lidhja Demokratike e Kosovës kësaj radhe nuk ka të drejtë. Të gjithë bashkëluftëtarëve të mi dua t'u them që unë nuk do të pranoja asnjëherë të jem veteran i një ushtrie pa kolegët e mi, kudo që ata kanë luftuar. Prandaj, zoti Quni, unë nuk pranoj të jem veteran pa ty, por ky ligj nuk të përjashton as ty, as gjithë bashkëluftëtarët, kudo që kanë qenë ata. Faleminderit!

KRYETARI: Deri në mëngjes nëse doni! Replikë, Anton Quni.

ANTON QUNI: Unë me të vërtetë e falënderoj gatishmërinë e kolegut tim, vëllait tim të armës, të idealit e të kauzës që shpreh gatishmërinë që të solidarizohet me të drejtat tona të veteranëve, duke u lidhur edhe me emrin tim.

Por, nëse me të vërtetë mendon të solidarizohet, atëherë le ta pranon këtë fakt: Shtabi i Përgjithshëm mund ta mbulojë luftën time vetëm nga 11 maji i vitit '99, sepse me këtë datë është zyrtarizuar nga Shtabi i Përgjithshëm njësia të cilën unë e kam udhëhequr, nën komandën e kolonelit Rrustem Berisha.

Kurse në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes isha nga marsi i vitit '98 dhe njësia ime ishte operative nga korriku i vitit '98, dhe është fatkeqësi që armiku ynë e pranon luftën time që nga shtatori i vitit '98, kurse kolegët e mi, vëllezërit e mi të ardhmes nuk janë në gjendje të përpijnë këtë fakt. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne edhe ashtu në lexim të parë i kemi dhënë përkrahje në parim këtij projektligji. Dallimet ndërmjet asaj se pse është dashur të jetë një amendament, edhe atë e kemi shpjeguar. Jemi në një fazë të cilën duhet të merret vendim për votim.

Unë mendoj që arsyet që ju i theksuat pikë së pari dhe deputeti Rexhep Selimi si eksponent i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk qëndrojnë me fjalët që i thoni, apo tentoni që të paraqiteni para qytetarëve të vendit. Tash po ju them pse. Unë mendoj dhe Grupi Parlamentar i LDK-së ka dashur që këtë çështje ta rregullojë njëherë e përgjithmonë nëpërmjet amendamentimit të këtij projektligji, sepse nuk ka ligj tjetër. Nëse ju mendoni se duhet të jetë një ligj tjetër, apo asaj që i apostrofoheni edhe ju personalisht, përshkrimi të historisë eventuale, ajo është diçka tjetër që ne duhet të bisedojmë herë tjera, por kësaj radhe e kemi një ligj para vetes dhe dëshirojmë që askush të mos mbetet tij.

E kemi thënë edhe në fillim, për herë të parë në këtë Kuvend, të quajtur i Republikës së Kosovës, po bëhet përkufizimi për luftën çlirimtare të Kosovës, e para. E dyta, po bëhet përkufizimi se kush dhe ku ka qenë i regjistruar në mbrojtje të vendit, dhe kjo është ajo që ne po kërkojmë. As nuk po tenton askush t'ia mohojë dikujt tjetër, as t'ia marrë e as t'ia rrisë meritat, qoftë edhe në individ. Nëse dëshironi për temat tjera që lidhen me luftën, kjo është shumë normale edhe të bisedojmë, por jo të luhet me ndjenjat e veteranëve në shumë aspekte.

Aspekti i parë është përmirësimi i kushteve të tyre, e dyta është përfshirja e të gjithëve dhe e treta të thirret dikush që ne kemi qenë të unifikuar dhe sot po dëshirojmë prapë ta mohojmë një fakt, që vetvetiu Rexhep Selimi e tha - Ministria e Mbrojtjes dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, askush prej LDK-së në jetë nuk ka thënë që nuk ka pasur Ushtri Çlirimtare të Kosovës. Nuk po di kah po e shpikni këtë si deputetë.

Nëse ka mendime edhe për kohën edhe për rrethanat, ne vendosim, por do të vendosim me votë. Mos harroni se me votën kundër, duke i ndarë luftëtarët e lirisë, jeni kah ia bëni të njëjtin shërbim vendit siç ia keni bërë ju dhe ata të tjerët gjatë luftës. Prandaj, unë si deputet dhe të tjerët si deputetë jemi duke marrë vendime për këtë kohë, e duhet ta arsyetojmë mirë çdo veprim tonin.

Nëse dëshironi të vazhdoni që dikë ta përkëdhelni e dikë ta gjuani, nëse forcat paramilitare serbe të veriut dëshironi t'i inkorporoni në Forcat e Sigurisë të Kosovës, në Forcat e Armatosura, si trashëgimtare e UÇK-së, dhe një trupë operative ushtarake me komandë të veçantë, me organizim të veçantë, nën emblemën e UÇK-së, të mos përfshihet në ligj, mbajeni për vete!

Edhe tash po e përfundoj pikërisht me ty, zoti kryetar, me një fjalë që e dëgjova kur e themelove Nismën atje në Drenicë. The 'Drenica ende nuk është e lirë për të vepruar politikisht'. Tash po ta përsëris edhe këtu: nëse ju vazhdoni ta ngulfatni demokracinë dhe njerëzit të mos kenë qasje të shprehur për atë që ka ndodhur dhe për të vërtetën, atëherë e paçi me shëndet.

KRYETARI: Deputet, sa i përket vetes sime, unë po të tregoj që nuk jam pishman as për një gjë që e kam bërë, as që e kam thënë, e nëse dikush ka komplekse nga historia e vet, le të mbetet çështje e tij. Unë nuk mund t'ua përmirësoj historinë atyre që nuk kanë histori.

Fjalën e ka Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Nuk po dua t'i përsëris ato që i foli më herët kolegu ynë Rexhep Selimi, por e vërteta është që çdonjëri që e ka kapur pushkën, e ka pasur mundësinë të aplikojë në Komisionin për ilustrim. Në formularë janë tri kategori të cilat i përmbledhin secili prej atyre që ka qenë i uniformuar dhe i armatosur, pavarësisht periudhës kohore.

Në rast se është kontesti që nuk quhet veteran u UÇK-së, por quhet pjesëtar, ose anëtar, ajo është diçka tjetër, por nëse flasim se çfarë bindje politike kam pasur unë kur kam qenë ushtuar i UÇK-së, kjo është krejt diçka tjetër.

Ne sot jemi kah e trajtojmë një kategori të caktuar, e cila e ka dhënë një kontribut qoftë edhe modest në luftën e fundit dhe me të drejtë ndoshta edhe jemi vonuar, e kemi përsëritur disa herë që duhet dhënë dinjitetin, qoftë edhe moral e financiar atyre njerëzve, t'u njihet e drejta, por në asnjë variant ky ligj nuk e mohon secilin prej atyre që e ka dhënë kontributin, qoftë edhe më simbolik. Ky ligj e njeh.

Edhe formulari të cilin shumica prej njerëzve e kanë mbushur dhe jam i bindur që edhe zoti Quni e ka mbushur atë formular për të qenë veteran i luftës dhe tash unë nuk e shoh këtu kontestin, sepse sot po tentohet të bëjmë dy paralele, dy ndarje. Jo në luftë! Është tentuar edhe më herët, po vazhdohet me çdo kusht që të futet një hendikep ndërmjet dy kategorive. E përsëris edhe një herë: të gjithë ata që i kanë mbushur formularët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do ta gëzojnë statusin, pavarësisht u votua për apo kundër këtyre tri amendamenteve të propozuara nga LDK-ja.

Nuk është qëllimi që të diskriminohet në asnjë formë asnjë kategori, e cila ka dhënë kontribut, por ky ligj është për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Rexhep? Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë njëjtë do t'i drejtohesha vëllait të gjakut dhe të pushkës Anton Qunit, ashtu siç m'u drejtua ai, sepse kështu e konsideroj, por duhet ta them një gjë edhe një herë:

pikërisht një unitet i cili ka ekzistuar në luftë, në fronte, mund të rrezikohet nëse vazhdojnë të bëhen ndarje të reja sot me ligj në formacione të ndryshme.

Prandaj, kërkesa e juaj, kërkesa e Grupit tuaj Parlamentar, nuk është thjesht për mbrojtjen e veteranëve, kushdo që kanë qenë, për shkak se ata nuk janë të rrezikuar. Në fakt, kërkesa, ta themi hapur, është për mbrojtjen e një primati të organizimit të luftës, gjë që është e kundërta prej asaj çfarë po thuhet këtu.

Kushto që ka dashur hise në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e ka hisen në këtë ligj, por kushdo që e ka mohuar të ketë hise në atë luftë, nga kushdo që ka ardhur, atëherë nuk do të duhej të kërkonte hise në këtë ligj. Pra, edhe një herë dua të them që pikërisht unitetit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unitetit të luftës së UÇK-së, unitetit të luftës çlirimtare të Kosovës, do t'i kontribuohet nëse nuk e involvojmë politikën, prandaj edhe një herë po mendoj që amendamenti juaj e involvon edhe politikën në kuadër të Ligjit për veteranët e UÇK-së.

E përsëris edhe një herë: nëse doni ligj për veteranët e politikës, atëherë sponsorizojeni një tjetër. Këtu është Ligji për veteranët luftës dhe mendoj që këtu bashkohemi me të gjithë bashkëluftëtarët e mi, kushdo dhe kudo që ka kontribuar për luftën dhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

KRYETARI: Anton Quni, një minutë replikë!

ANTON QUNI: Faleminderit, kryetar!

Është fakt që ne i kemi plotësuar aplikacionet, tani po e marr shembullin personal. Unë në aplikacion për dëshmitarë që e mbulojnë domethënë luftën time, angazhimin tim, e kam cekur Rustem Berishën, komandantin tim të brigadës, dhe ministrin e Mbrojtjes, Ahmet Krasniqi.

Unë me të vërtetë nuk e kuptoj tani sesi do të shkojë kjo: a do të varet nga mëshira e kryeministrit, nga mëshira juaj, a do ta rregullojnë këta popullorçe, në mënyrë tradicionale, do të ulemi, pranojmë, nuk pranojmë e tjera, apo do ta rregullojnë këta siç i ka hije një shteti modern, të kulturuar, demokratik, të mbuluar me ligje e tjera. Do të thotë, për gjithë atë unitetin që ju flisni, urdhëroni tregojeni me ligj, dhe çdo veteran i luftës le të jetë i mbuluar dhe le të jetë i siguar me ligj.

Pjesën time, derisa njësia ime është zyrtarizuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë vetëm dua të ritheksoj atë që e kemi theksuar edhe më herët. Ky është Ligji i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është ligj i punuar prej organizatave të veteranëve të Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, që janë sot të pranishëm në Kuvend. Ky

ligj është mbështetur plotësisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe është punuar ngushtë, është respektuar vullneti 100% i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Tash edhe një herë e ritheksoj - qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në benificione të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar në luftën çlirimtare të Kosovës, ishin faktor vendimtar për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.

Pra, ky është Ligji i veteranëve dhe nuk është ligji i politikës ditore. Askush askujt për asnjë moment nuk do ta mohojë kontributin e asnjë ushtari dhe veterani të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të gjithë ne që kemi qenë në UÇK e kemi pasur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kudo që kanë vepruar, kudo që kanë qenë te angazhuar. Unë dhe sytë e mi nuk kanë parë diku ndonjë ushtar me ndonjë uniformë tjetër, përpos Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, edhe një herë e theksoj Ligji është i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe i nevojave të tyre. Ftoj që mbi politikën e interesit ditor, të shkohet në votim dhe ta procedojmë. Është ligj integruar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Daut Haradinaj, replikë!

DAUT HARADINAJ: Po, shumë shkurt. Secili sektor regjional është i përfaqësuar me një anëtar në komision. Po ashtu, edhe një anëtar në komision është nga brigada, e po ashtu kolegu i mëhershëm që foli e ka anëtarin në komision dhe ai është përgjegjës për ilustrimin e listave të të gjitha njësive, të cilat janë dorëzuar po ashtu nga kolegu im. Domethënë, nuk mund ai anëtar t'ia mohojë kontributin në asnjë rrethanë asnjë njeriu, i cili ka marrë pjesë në luftë. Faleminderit!

KRYETARI: Për këtë amendament, Sabri edhe ti e ke fjalën dhe shkojmë në votim.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Le të bëhemi legjislatorë, se këtu sot jemi legjislatorë. Diskutimi është politik edhe sot, e ne jemi te amendamenti nr. 3, i cili nuk e rregullon krejt këtë lëmi që po flasim njëri pas tjetrit, por është amendamenti numër 3, zoti kryetar, jemi momentalisht, i cili ka të bëjë me nenin 3, te pika 1.1, të ndryshimit të Ligjit në vijim.

Le të bëhemi konkretë. Prandaj, më lejo, zoti kryetar, të bëhem konkret dhe të them çfarë thotë ky amendament. Të mos mendohet që ne po flasim se kush e ka hartuar ligjin, me kë ka të bëjë ligji e tjera. Që e ka sponsorizuar Qeveria, ka bërë mirë, se është punë e saj. Që kanë ndihmuar shoqatat, është shumë mirë, por ky është ligj që e nxjerr populli i Kosovës nëpërmjet Kuvendit të Kosovës për këtë kategori. Nuk është ligj që e nxjerr kjo kategori për vete dhe kjo është fundamentale për ne këtu, edhe kur bisedojmë, edhe kur bëjmë nene, edhe kur precizohet.

LDK-ja e ka votuar këtë ligj në lexim të parë. Ju i keni atje firmat, e dini që kemi votuar, prandaj nuk ka të bëjë këtu a duhet ta votojmë, a të mos e votojmë. Problemi është që ligji është në lexim të dytë dhe në leximin e dytë i kemi këto amendamente. Momentalisht jemi te amendamenti nr. 3, që ka të bëjë me nenin 3.1, pika 1, dhe zonja e zotërinj deputetë, kjo nuk ka të bëjë me krejt ligjin. Ka të bëjë me një përkufizim që është fundamental për mua dhe këtu ju kam thënë edhe në diskutimin herën tjetër dhe ju kam thënë do të ketë plasoja largvajtëse sesi do të formulohet, e kjo ka të bëjë me konceptin - 'lufta çlirimtare e Kosovës'.

Pra, nuk është 'veterani', por është 'lufta çlirimtare e Kosovës'. Për këtë përkufizim, LDK-ja ka ofruar: 'Lufta çlirimtare e Kosovës LÇK, është lufta e armatosur e popullit të Kosovës, e organizuar në formacione luftarake, e udhëhequr nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe nga Ministria e Mbrojtjes për çlirimin e Kosovës dhe të arritjes së lirisë e të pavarësisë të popullit të Kosovës. Lufta Çlirimtare e Kosovës ka pasur karakter mbrojtës të popullit të Kosovës dhe karakter çlirimtar, e drejtuar kundër forcave ushtarake policore dhe administratës okupuese të Serbisë në Kosovë'.

Unë them që për shumëçka, ky definicion, i ofruar nga LDK-ja, është më gjithëpërfshirës, më i saktë. Unë i thërras deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm fizik i kemi 97 deputetë. Shkojmë në votim. ... 99 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë amendamentin e tretë, i propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Konstatohet se me 38 vota për, 57 kundër dhe 1 abstenim, nuk kalon amendamenti i tretë.

Votojmë amendamentin 4, propozim i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe në lidhje me këtë amendament, arsyetimi është i së njëjtës natyrë. Zoti kryeparlamentar, dua të theksoj edhe diçka që nuk ka lidhje me këtë amendament, a është rastësi, a është koincidence apo është një përgatitje e mirë se si do të shfaqet kjo seancë dhe kërkesat tona, por ta keni në dijeni, por gjatë fjalës sime, RTK-ja e ka ndërprerë transmetimin.

Por, në lidhje me këtë amendament, arsyetimi është i të njëjtës natyrë, si në rastin e amendamentit numër 3. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, kush dëshiron e merr fjalën. Andaj, nuk ka nevojë të... shiko, në orën 4 gjithnjë ai ndërpritet, por e ka kanalin tjetër... unë nuk e di, prandaj është komisioni përkatës, le ta shqyrtojë atë çështje, unë s'merrem me televizionin.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kjo është ajo që vazhdon, shteti diktatorial, zoti kryetar. Edhe kjo që ndodh me RTK-në nuk është e rastësishme, por ajo që e ke përsëritur në Drenicë, po ta përmend edhe një herë. Domethënë, që nuk ka liri, nuk ka demokraci në këtë vend. E vazhdojeni, pra. Kjo është e njëjta edhe çka po ndodh me këtë, absolutisht.

Kjo politikë i ngjason kohës së Rankoviqit, mbajeni në mend. Edhe vazhdoni demokracinë...

KRYETARI: Krahasset nuk po i bëni bash mirë... po, ne vazhdojmë me procedurën e votimit.

Votojmë amendamentin e 4-të i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Konstatohet se me 35 vota për, 57 kundër, 2 abstenime, nuk kalon as amendamenti 4.

Amendamenti i 5-të i ka dy propozime. Propozimi i parë është i Komisionit Funksional dhe propozimi i dytë është i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Fillimisht e votojmë amendamentin e Komisionit Funksional, pastaj dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Me 68 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti i 5-të propozim i Komisionit Funksional.

Për të respektuar Rregulloren, jemi prezentë 74 deputetë, votojmë edhe për amendamentin b të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Për variantin b ka votuar vetëm 1 deputet, 59 kanë votuar kundër, 1 ka abstenuar. Kështu që edhe s'ka arritur numri 61, por nuk do të thotë... mirë faleminderit, se gabova. Do të thotë, votohet amendamenti i 5-të i Komisionit Funksional, nuk votohet varianti b i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Amendamenti 6 është i propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

2 për, 60 kundër, 3 abstenime, nuk miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7 i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

2 vota për, 62 kundër, 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti 7.

Votojmë amendamentin 8 i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Me 3 vota për, 60 kundër, 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti 8.

Për amendamentin 9, është i Komisionit Funksional.  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17  
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Urdhëro, fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!  
Të nderuar deputetë,

Te neni 31, në amendamentin e 17, kemi pasur një shkaqe teknike edhe në komision kemi marrë njëzëri dhe propozojmë që amendamentin 17, ose te neni 31 të shtohet fjala “dhe fëmijët e tyre”, ashtu që amendamenti ose neni 31 do të jetë “Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin universitar publik është e drejtë, të cilën mund të realizojnë veteranët e luftës dhe fëmijët e tyre.”

KRYETARI: A jeni dakord, që me këtë ndryshim?  
Faleminderit!

Amendamenti 18 është i deputetit Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Deputet e ke të drejtën e arsyetimit të amendamentit.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti i propozuar prej nesh ka të bëjë me ruajtjen e dinjitetit të veteranit të UÇK-së, duke mos lejuar mundësinë e askujt, që idealet, qëllimet e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës t’i përdhosin individët e pandërgjegjshëm.

Ligji për veteranët e luftës përcakton kriteret, në bazë të cilave një qytetar i Kosovës mund të fitojë të drejtën për të qenë veteran i luftës, por nuk përcakton kriteret kur një qytetar që ka përfituar nga ky ligj mund t’i humbë ato.

Amendamenti i propozuar prej nesh përmban këtë tekst: “Cilido përfitues nga ky ligj, që ka tradhtuar interesat e vendit, u ka bërë shërbime direkte apo indirekte armiqve kundër të cilëve kanë luftuar veteranët e UÇK-së, ka vënë në rrezik apo ka dëmtuar sovranitetin e vendit, ka keqpërdorur pasurinë dhe paratë publike apo është dënuar për krime ekonomike, përjashtohet nga përfitimi financiar dhe benificionet e parapara me ligj”.

Amendamenti ka për qëllim t’ia heq, jo meritat por përfitimet financiare dhe benificionet secilit qytetar që pas luftës ka rënë ndesh me idealet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shembull duke u bërë spiun i Serbisë, duke bërë vepra në dëm të interesave të vendit, duke nënshkruar marrëveshje, që bien ndesh me interesat kombëtare, duke bërë shërbime direkte apo indirekte ndonjë shteti që mban qëndrim armiqësor ndaj nesh, e kështu me radhë.

Pra, nuk mund të përfitosh benificionet e veteranit të luftës dhe të njëjtën kohë të jesh dënuar për vepra, që bien në kundërshtim me vlerat themelore të luftës. Pra, kjo ka qenë ideja e këtij amendamenti, për arsye procedurale e tërheq amendamentin.

*(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)*

KRYETARI: Urdhëro, Faton!

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Unë e lexova amendamentin për të cilin fola, ndoshta kam gabuar në radhitje. Kjo ishte për amendamentin të cilin e lexova, ndërsa, nëse është fjala për nenin 40, kam një arsyetim tjetër.

KRYETARI: Shiko, e ke amendamentin 18 të nenit 40.

FATON TOPALLI: Jo, për nenin 40, jemi keqkuptuar, kam një arsyetim. Ju lutem. Nuk e tërheq. 19-shin e kam tërhequr, jo...

KRYETARI: Mirë, atëherë arsyetoje 18-shin, se për 18-shin ta dhashë fjalën.

FATON TOPALLI: Ju kërkoj falje për keqkuptim.

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Neni 40 është vendimtar, sa i përket Ligjit për veteranët e luftës. Unë po lexoj nenin 40. “Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, pagesa e cilitdo dhe të gjitha benificioneve financiare të siguruar nga ky ligj, duhet të kërkojnë vetëm deri në atë masë që fondet janë përvetësuar veçmas për një qëllim të tillë, sipas ligjit të aplikueshëm për buxhetin vjetor”. Pra, kjo i bie që mund të përfitojnë vetëm nëse është ndarë buxheti.

Pika 1.2 thotë, ka fonde të mjaftueshme, faktikisht në dispozicion për pagesa të tilla. Pra, ka raste kur Qeveria mund të ndajë më shumë mjete për një autostradë dhe të thotë se s’ka në dispozicion më shumë mjete për veteranët e luftës.

Qeveria nuk ka lëshuar vendim nën paragrafin 2 të këtij neni, që redukton apo eliminon pagesa të tilla, pra, nëse Qeveria nuk vendos ndryshe.

Problemi fillon dhe thellohet me paragrafin 2 të këtij neni. Në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme, për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparaparë fiskale në buxhetin publik, apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin, që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo benificioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë benificionet që kanë të bëjnë me pagesat financiare, madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.

Pra, edhe nëse janë ndarë mjetet me buxhet, Qeveria mund të vendos të mos i paguajë. Një tendosje e paparaparë fiskale mund të vijë në rastin konkret kur një qeveri për efekte elektorale ngrit pagat, pensionet prej 25-50%, ndërsa nuk ka mbulesë reale, për t’i përmbushur ato. Në rrethana të tilla, sipas projektligjit aktual, mund të ndalen pagesat financiare dhe benificionet për veteranët e UÇK-së.

Lëvizja “Vetëvendosje” e kundërshton këtë nen të Ligjit për veteranët e luftës, për shkak se ky nen i mundëson një qeverie të ardhshme të Kosovës, që me një vendim qeveritar t’i reduktojë pensionet dhe benificionet, madje t’i eliminojë fare ato.

Ne duam që në çdo kohë përderisa deputetët t’i marrin rrogat e tyre, nëpunësit civilë, të moshuarit, pensionistët e pleqërisë, t’i marrin edhe veteranët e luftës pensionet e tyre.

Neni 40 nuk u garanton mbështetje të qëndrueshme financiare dhe benificione të parapara me ligj. Në asnjë vend demokratik në botë, qeveria nuk ka të drejtë heqjen e të drejtave të sanksionuara me ligj dhe të miratuara nga Parlamenti. Sipas nenit 4, Qeveria na del mbi Parlamentin, sepse ka të drejtë të reduktojë dhe eliminojë çfarëdo pagese financiare. Me fjalë të tjera Qeveria ka të drejtë në çdo kohë ta eliminojë këtë ligj. Atëherë, shtrohet pyetja - pse duhet të ekzistojë ky ligj në qoftë se Qeveria mund ta tërheqë kur të dëshiroj?

Prandaj, lus deputetët që neni 40 të ndryshohet ashtu siç kemi propozuar ne.

**KRYETARI:** Ardian Gjini, pastaj kryeministër ta dëgjojmë edhe Ardianin çka po na thotë.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, kryetar!

E di që Fatoni e din, por e kam për Fatonin. Ky nen është për shkak se dikush i ka thënë Qeverisë - a e dini që mund t'ju ndodh si në ndonjë vend këtu në Unionin Europian, të bankrotoni krejt dhe nëse bankrotoni dikush duhet pasur autoritetin për të thënë ndal një herë se s'kemi hiç.

Domethënë, kjo është ajo çka ka ndodhur. Me të vërtetë kesi nene në ligje nuk duhet të ketë. Nene të këtij lloji, domethënë që kur bëhet ligj, diçka për t'i u dhënë autoriteti Qeverisë për të lëvizur, mund t'i kuptoj ato aspektet tjera, por po më duket që kemi nevojë t'i themi: ky nen u bë për shkak se shpenzimet tjera kanë shkuar në nivele të pabesueshme dhe dikush i ka thënë Qeverisë, ndonjë FMN a ndokush i ka thënë: ndal ngadalë njëherë se s'pajtohem me ju nëse nuk e vëni këtë klauzulë, se jeni kah doni ta bankrotoni krejt. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëro, kryeministër.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Formulime të tilla, të nderuar deputetë, janë të gjitha ligjet dhe unë ju kisha ftuar t'i lexoni.

Një formulim i tillë është plotësisht në harmoni edhe me rekomandimet e veteranëve të luftës dhe të Qeverisë, por për hir të ligjit, ne do ta kemi parasysh dhe ju ftoj të gjithëve që ta votojmë rekomandimin që ishte edhe prej Aleancës dhe prej "Vetëvendosjes". Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni!

**HYDAJET HYSENI:** Faleminderit!

Por, nëse e kuptova drejt fjalën e kryeministrit që sipas të cilës pajtohet me këtë, atëherë s'kam nevojë të sqaroj. Po desha edhe të sqaroj, meqë e mora fjalën, që në të vërtetë edhe angazhimi i Gjinit edhe angazhimi i bartësit të amendamentit, duhet të dalin të bazuar, sepse formulimi është këtu shumë relativ. Po të ishte të thuhet ta zëmë, në rast të situatës së jashtëzakonshme që dëmton seriozisht stabilitetin fiskal, do të mund të merrej në konsideratë.

Po mendoj meqë kryeministri e rregulloj me këtë, unë bëra veç një sqarim pse e kërkova fjalën, por pajtohem me një qasje të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Hydajet, unë isha shumë i qartë. Formulime të tilla ka në çdo ligj, por për hir të ligjit, pajtohem edhe me Ardianin, edhe me këtë djalë e Vetëvendosjes edhe me ju, e dhe me të gjithë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faton, e do fjalën? Jo.

Atëherë, shkojmë në votim.

Dëgjuat çka u tha nga të gjitha anët, dhe votojmë:

Amendamenti 18, i deputetit Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë tash!

Me 65 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstenime – Kuvendi do të thotë e miratoi amendamentin 18, i propozuar nga deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti 19, është tërhequr.

Votojmë amendamentin 20.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Do të thotë, është i Komisionit Funksional. Pra, miratohet.

E tani e votojmë ligjin në tërësi.

Jo, nuk ka fjalë më!

Lus deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 73 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Tash po vazhdojmë tutje, deputetë.

Për pikën e katërt, duhet t'i kemi 80 deputetë, nuk i kemi. E heqim nga radha dhe e lëmë për më vonë, nëse na vijnë deputetët tjerë.

Pyetjeve parlamentare, po më duket se Qeveria nuk është e gatshme për t'iu përgjigjur.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet dhe pajisje medicinale**

Është tash votimi i amendamenteve, dhe lus deputetët që të rrinë në sallë. Sa është prania fizike?

*(Ndërprerje)*

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

Deputete mund ta parashtrosh pyetjen.

TIME KADRIJAJ: Po as në seancën e kaluar e as sot, zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë nuk është.

Çështja ka qenë se shumë familjarë të personave të zhdukur apo të viktimave civile janë të preokupuar, sepse në disa raste për shkak të mosmundësisë së ekzaminimit të kufomave të karbonizuara edhe pse këta persona janë të identifikuar, kanë varreza dhe ka dëshmitarë që janë vrarë, janë kategorizuar në kategorinë e personave të zhdukur.

Cila është mundësia ligjore që këta persona të kategorizohen në kategorinë e viktimave civile?

Ndoshta, zëvendëskryeministri do ta shfrytëzojë mundësinë që të na përgjigjet me shkrim?

KRYETARI: Deputete, unë jam i interesuar për atë çështje, po më është dhënë një përgjigje që sipas standardeve njerëzit që nuk kanë varr, do të thotë, trajtohen si të zhdukur.

Pra, sipas standardeve jam i interesuar për këtë çështje, por më është dhënë kjo përgjigje, nëse bash je e interesuar, edhe unë kam qenë i interesuar.

Deputetja Lumnije Morina, pyetje për ministrin Bernard Nikaj.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i ka pasur të autorizuar 2 laboratore për testimin e derivateve të naftës deri më 20 janar 2014.

Sipas udhëzimit administrativ 07/2012 për vazhdimin e autorizimit për laboratorët e autorizuar kërkohet së paku 30 ditë para datës së skadimit të autorizimit të bëhet kërkesa për vazhdimin e autorizimit.

Konform udhëzimit administrativ 07/2012 laboratorët e kanë bërë kërkesën, laboratorit SIERA-LAB, SHPK ka bërë kërkesën me 27.12.2013, kërkesat janë shqyrtuar dhe janë vlerësuar nga komisioni prej 5 anëtarësh i cili komision e ka dhënë vlerësimin dhe

rekomandimin pozitiv për nënshkrimin e autorizimit nga ministri Bernard Nikaj, para datës 28 janar 2014 për të dy laboratorët e autorizuar të derivateve të naftës në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të autorizimit.

Laboratori SIERA-LAB, SHPK nuk ka marrë përgjigje, ndërsa laboratori Kosova-Lab është autorizuar.

Pyetja për ministrin është: nëse laboratori SIERA-LAB, SHPK, i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret që kërkohen për autorizim dhe vazhdim të autorizimit atëherë edhe çfarë kushti tjetër duhet plotësuar nga domethënë laboratori SIERA-LAB që ky laborator të autorizohet përsëri? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BERNARD NIKAJ: Faleminderit!

Faleminderit e nderuara deputete për pyetjen. Më lejoni që fillimisht t'ju jap një përshkrim të shkurtër të procesit të autorizimit të trupave të vlerësimit të konformitetit.

Procesi i vlerësimit bazohet në Ligjin për vlerësim të konformitetit numër 04/L-039 dhe Udhëzimit 07/2012 dhe për cilësinë e derivateve të naftës dhe 16/2011 për mënyrën e autorizimit të trupave për vlerësim të konformitetit.

Gjatë këtij procesi përveç kapaciteteve teknike dhe njerëzore vlerësohet dhe shqyrtohet edhe performansa në punë e kompanive që aplikojnë për autorizim.

Duke pasur parasysh që bazuar në legjislacionin në fuqi, procesi i autorizimit nënkupton zgjatje të besimit nga Ministria përkatëse tek një operator privat që të kryejë punën me profesionalizëm dhe nderë, performansa e kompanisë ka rëndësi kritike, posaçërisht gjatë procesit të zgjatjes së autorizimit.

Në rastin e kompanisë që ju intereson juve, është e vërtetë që Komisioni për vlerësim të kushteve teknike dhe të personelit e kanë dhënë një rekomandim që janë plotësuar kushtet teknike për shtyrje të autorizimit. Mirëpo, në të njëjtën kohë janë ngritur dyshime mbi profesionalizmin dhe etikën profesionale të kompanisë në kryerjen e këtyre detyrave që dalin nga autorizimi si dhe tejkalim të kompetencave gjatë kryerjes së punës në terren.

Duke pasur parasysh këto dyshime, Ministria ka kërkuar nga organet kompetente që të shqyrtohen dyshimet e ngritura dhe ka pezulluar në procedurat administrative të autorizimit. Posa të përfundojë shqyrtimi i këtyre dyshimeve, Ministria dhe departamentet respektive do të sigurohen që kompania ta marrë një përgjigje finale.

Prandaj, për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj, kompania duhet të presë deri sa të kryhet procesi i shqyrtimit të dyshimeve të ngritura dhe atëherë do të marrë përgjigjen finale për shtyrje apo jo të autorizimit, varësisht nga rezultatet e hetimit dhe shqyrtimit të dyshimeve. Ju faleminderit për pyetjen!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

LUMNIJE MORINA: I nderuar ministër,

Derisa Komisioni vlerësues, siç e thatë edhe ju, e ka bërë vlerësimin dhe ua ka dhënë dritën e gjelbër të dy laboratorëve dhe njërin e keni autorizuar dhe tjetrin jo, pse kompania në fjalë nuk ka marrë përgjigje për cilat arsye nuk i është vazhduar kontrata.

Është dashur së paku për çështje korrektësie të marrin ata një përgjigje. Ata u janë drejtuar me shkrim dhe ju është dashur me shkrim t'u drejtoheni.

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI BERNARD NIKAJ: Faleminderit! Edhe kompania ka marrë përgjigje me shkrim. Të gjitha këto që ua thashë unë juve, ju kanë thënë edhe kompanisë dhe ata janë të informuar për këtë gjendje. Kanë aplikuar dy laboratorë, për njërin ka pasur dyshime, për tjetrin s'ka pasur, kështu që ne vetëm e kemi pezulluar procedurën deri sa të kryhen hetimet dhe në momentin kur të kryhet nëse çdo gjë është në rregull, jo vetëm ata por çdo kompani që i plotëson kushtet, do të autorizohet.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Glauk Konjufca, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputet, mund ta parashtrosh pyetjen?

GLAUK KONJUFCA: Kjo është një pyetje e javës së kaluar, kur mungonte kryeministri dhe edhe sot po mungon, lidhur me shqiptarët e Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Unë kam pas dashur të di se në të gjitha takimet që ka pasur kryeministri me kryeministrin e Serbisë, Ivica Daçiq, sa herë është takuar atje, a e ka ngritur ndonjëherë çështjen e shqiptarëve nga kjo pjesë dhe nëse e ka ngritur, çka kanë përfituar shqiptarët e asaj ane konkretisht?

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Nijazi Idrizi, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Kam një pyetje për ju: Kur pritet të fillojë ndërtimi i rrugës Ferizaj – Gjilan – Dheu i Bardhë?

Këtë pyetje po e bëj duke pasur parasysh se në kornizën afatmesme të zhvillimit apo në planin afatmesëm të zhvillimit, nuk figuron as plani dhe as buxheti për këtë rrugë, por po ashtu nuk figuron as ndonjë projekt i cili do ta studionte dhe do ta kishte marrë në trajtim studimin e fizibilitetit të kësaj rruge.

Për më shumë, kjo rrugë po merr një rëndësi shumë të madhe, duke u nisur nga fakti se ne në rrugën panevropiane që e kemi pasur që na ka çua në Morinë-Merdar, kjo rrugë në njëfarë mënyre ka devijuar dy herë, një herë ka devijuar për 7 minuta e që askush nuk e di

se çka do të thotë kjo 7 minuta, do të thotë a janë kilometrat që vrapohet me 200 në orë apo ecët këmbë dhe devijimi i dytë është se nuk ka shkuar në Merdar, por ka shkuar në Mutivodë, një vend shumë i parëndësishëm i cili e bën edhe rrugën tonë nacionale të padobishme, por edhe portën e Durrësit, jo shumë joshës për qarkullim.

Me këtë projekt që është propozuar madje edhe ka premtim që do të bëhet, ky devijim do të mund të nxirrte këtë rrugë me një rëndësi të madhe, prandaj më intereson të di kur do të fillojë saktë ndërtimi i kësaj rruge? Faleminderit!

KRYETARI: A po mendon për autostradë të fushatave? Urdhëro ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Idrizi,

Pyetja e juaj pak sa u zgjerua nga ajo që unë kam marrë, por si do qoftë unë jam i thirrur të përgjigjem edhe për çështjet të cilat ju i keni ngritur.

Atëherë unë ju njoftoj se Ministria e Infrastrukturës sipas planifikimit të bërë në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2015-2017 e ka përfshirë projektin e ndërtimit të rrugës Ferizaj-Gjilan-Dheu i Bardhë.

Dhe, në vlerësimi i Ministrisë së Infrastrukturës është që këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve 2015-2017 është se gjatë vitit 2015 parashihet të kryhet projekti kryesor, domethënë parashihet projektimi detaj i rrugës Ferizaj-Viti-Gjilan-Dheu i Bardhë. Ndërsa, mundësitë buxhetore për fillimin e rrugës nëse flasim për një rrugë standarde dhe të rrugës Prishtinë-Pejë, ose Prishtinë-Mitrovicë, realisht duhet të presim fillimin e punimeve në vitin 2016.

Mirëpo, për informimin tuaj t'ju them se në aspektin e rehabilitimit të rrugës magjistrale mundësitë ekzistojnë që edhe në vitin 2015 ta bëjmë këtë punë, por meqë ka përpjekje që të ketë një rrugë të standardeve të larta, të rrugëve të hapura, sikur që është rruga Prishtinë-Mitrovicë dhe Prishtinë-Pejë, atëherë duhet një studim detaj i kësaj dhe në vitin 2016 të fillojë ndërtimi i kësaj rruge.

Ndërsa për informimin tuaj shtesë autostrada Morinë-Merdar do të jetë e tillë, Morinë-Merdar, tashmë është definuar kjo çështje dhe është ndarë një buxhet prej 500 mijë eurove për studime të fizibilitetit nga Truda, përkatësisht nga Besia aty ku ka përfunduar kontrata e parë deri në Merdar dhe do të jetë ai korridor i cili ka qenë i proklamuar më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Ke pyetje shtesë?

NIJAZI IDRIZI: Nuk kam pyetje, i nderuar kryetar!

KRYETARI: Mirë, vazhdojmë. E kam kapërcyer deputetin Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

FATON TOPALLI: Në fakt, pyetja është prej seancës së kaluar. Po e shtroj tani. Gjatë këtyre ditëve keni vizituar grupe të ndryshme të interesit, të burgosur politikë, sindikalistë, e keni takuar Organizatën e Veteranëve të Luftës, punëtorë, fermerë, sportistë. Të gjithë këta përbëjnë grupe të mëdha të interesit.

Është transparente që çdo lëvizje e juaj, çdo takim, çdo prononcim e matni me peshën e votës.

Këto ditë duke pritur 15 vjet miratimin e Ligjit për veteranët e luftës bëri vetëvrasje veterani i 46 i luftës. Kjo kategori qytetarësh sjell pak vota, por shumë trishtim për shumicën e qytetarëve të Kosovës, sepse të gjithë këta ishin të fuqishëm për t'i vënë gjoksin armikut, por nuk e mundën dot mjerimin që e keni instaluar ju, për të cilin ju kryeministër e bartni përgjegjësinë kryesore.

Dua t' ju përkujtoj edhe një herë letrën lamtumirës të një veterani në gjendje të rëndë ekonomike, të cilin ai i drejton gruas së tij dhe në mes të tjerash shkruan: "si më prezencën time ashtu edhe pa të, ti vetë po i rritë fëmijët, unë moti veç po ju shpenzoj se nuk po ju ndihmoj"

Këta 46 veteranë, kryeministër kanë fituar luftën mbi pushtetin serb, por mjerimi që e keni sjell ju duket të ketë qenë armik më i fuqishëm.

Pyetja: A keni takuar familjen e ndonjërit prej 46 veteranëve të luftës që janë vetëvrasë?

KRYETARI: Vazhdojmë! Faton, dëshiron ta lexosh edhe një pyetje? Deputetja Lirije Kajtazi s'është. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Teuta, do ta lexosh pyetjen?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime do të thotë lidhet me fushatën e kryeministrit që krahas kësaj fushate po bën edhe një tallje elektorale ekonomike përkitazi me shpalljen e zonave ekonomike, zonave të lira ekonomike.

Pyetja konkretisht është- çfarë kuptohet me koncept plan dhe ku mund të gjendet ky koncept plan, pse nuk e ka bërë publik Qeveria e Kosovës?

Kryetar kërkoj që pyetjen ta bart në seancën e radhës në mënyrë që qytetarët e komunës së Gjakovës ta dinë se çfarë thjesht përfitojnë nga ky koncept plan i kryeministrit.

KRYETARI: Pyetje, Alma Lama, nuk është. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. Albulenë e ke fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më 18 mars 2014 BBC World ka publikuar një material ku tregon qartë se askush nuk guxon që në pjesën veriore të Mitrovicës të tregojë atë që zonja Tahiri dhe e gjithë Qeveria e quajnë integritet territorial dhe shtrirje e sovranitetit të Kosovës.

Pra, në këtë video të publikuar nga BBC World shihet se si një pjesëtar i policisë së Kosovës i heq tabelat me RKS nga vetura private. Pra unë i kam edhe fotografitë këtu, andaj pyetja është se zonja Tahiri, në javën e kaluar tha që nga 28 barrikada tani kanë mbetur vetëm 2, ndërsa mediet ndërkombëtare tregojnë paaftësinë e kësaj Qeverie për të shtrirë sovranitetin në veri të vendit.

Pra, duke qenë se zonja Tahiri është bërë shumë e zhurmshme, pra me trumbetimet e saj që kinse po shtrihet sovraniteti në veri të vendit dhe kinse po shpërbëhen strukturat paralele, atëherë do të ishte mirë që t'ju tregojë qytetarëve se pse pra një pjesëtar i Policisë së Kosovës duhet t'i heqë tabelat te Ura e Ibrit? Unë po e pres përgjigjen javën që vjen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Afrim Hoti, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Meqë kryeministri s'është këtu, unë po e lexoj pyetjen. Kisha dashur të di, në një video të publikuar kohëve të fundit, shihet qartë, ish shefi i SHIK-ut dhe kryeministri, domethënë, Kadri Veseli duke i ndaluar mjekët e komunës së Mitrovicës për të shkuar në vendet e tyre të punës në spitalin në pjesën matanë Ibrit.

Kisha dashur të dijë, pyetja është: Cili ishte roli i kryeministrit dhe i Kadri Veselit në atë kohë, pse i ndaluan mjekët shqiptarë të shkonin në vendin e tyre të punës? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në një raport Amnesty Internacional thuhet se ka pasur heqje të mitrave dhe abuzime seksuale me pacientët në Institutin Special në Shtime.

Po ashtu edhe gazeta Koha Ditore e ka bërë një hulumtim dhe ka shkruar për këtë rast më datën 27 mars të këtij viti, në këtë hulumtim tregon se ka pasur keqtrajttime të pacientëve, ngacmime seksuale, shfrytëzim dhe dhunime.

Pyetja për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është se çka ka ndërmarrë kjo ministri në lidhje me këto raste? Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Afrim Hoti, pyetje për zëvendëskryemnistin dhe ministrin Hajredin Kuçi.

AFRIM HOTI: Po ashtu po e lexoj pyetjen. Faleminderit, kryetar!

Më 27 janar 2011, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit e ka miratuar nismën e kryetarit të kësaj komune për të iniciuar padi kundër Serbisë për krimet e kryera nga forcat e saj

ushtarake dhe paraushtarake ndaj popullatës civile të kësaj komune gjatë luftës në Kosovë.

Siç e dimë krimet e luftës nuk parashtrohen, në takimet që Qeveria e juaj ka zhvilluar me kryeministrin e Serbisë, Ivica Daçiq, as që e keni përmendur këtë çështje.

Pyetja është: Zoti ministër, ne e dimë që në këto bisedime ju nuk keni ngritur këtë çështje. Më intereson të informohem se a jeni duke përgatitur dokumentacion me dëshmitë dhe faktet për krimet e Serbisë në Kosovë? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me pensionistet dhe pensionistët, të cilëve u ndërpriten pensionet zakonisht në muajin tetor, në qoftë se ata nuk e vërtetojnë, apo ato nuk e vërtetojnë se jetojnë. Meqë ministri mungon, pyetjen po e lë për javën e ardhshme.

KRYETARI: Deputeti Elmi Reçica, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri është këtu. A i ke rënë pishman?

ELMI REÇICA: T'i e di që unë s'i bie pishman fort, se goxha si të njëjtë për pishman jemi. Faleminderit!

Faleminderit, kryetar!

Përsëendetje për dy ministrat,

Është një çështje që realisht kam menduar ndoshta ta shtroj si çështje urgjente, se është bukur urgjente, por do ta parashtroj tash si pyetje parlamentare.

Ndërrimi i lokacionit të Spitalit Regjional të Ferizajt - Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë, në rishikimin e buxhetit të vitit të kaluar ka ndarë mjete për ndërtimin e Spitalit Regjional të Ferizajt.

Kuvendi Komunal i Ferizajt, përkatësisht asamblistët e kanë marrë një vendim për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Regjional të Ferizajt, i projektuar kohë më parë.

Ndërrimi i lokacionit është bërë thjesht për arsye dhe motive politike dhe ka për qëllim bllokimin e fillimit të ndërtimit të këtij spitali jetik për qytetarët e regjionit të Ferizajt, brenda të cilit ka 5 komuna.

Përcaktimi i këtij lokacioni afër Kazermës së FSK-së, së shpejti Forcave të Armatosura të Kosovës, është jashtë çdo konventë dhe çdo rregulli që një spital civil të jetë pranë një kazerme ushtarake, kur dihet mirëfilli puna dhe aktiviteti i ushtrisë dhe nevoja e pacientëve për shërim dhe rehabilitim të tyre kërkon vende shumë më adekuate.

Pyetje: I nderuar zoti ministër,

Sa mendoni që ndërrimi i lokacionit për ndërtimin e spitalit nga Kuvendi Komunal i Ferizajt, duke u zhvendosur pranë kazermës ushtarake, e dëmton projektin, koston, dhe sa dëmton interesin e qytetarëve të Ferizajt, duke i afruar pacientët pranë një ambienti ushtarak, pranë kazermës ushtarake, kur dihet aktiviteti i ushtrisë dhe nevojat e pacientëve për shërim dhe rehabilitim. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kuvendar,

Siç e dini, i nderuar zoti deputet Reçica, edhe në mandatin e kaluar të Kuvendit Komunal, Ministria e Shëndetësisë e ka shprehur gatishmërinë e plotë për të marrë pjesë në ndërtimin e Spitalit të ri të Përgjithshëm në qytetin e Ferizajt për arsye të shumta.

Në ndërkohë ka ardhur deri te ndërrimi i përbërjes së Kuvendit dhe jam i informuar edhe nga kryetari i Komunës së Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars të këtij viti, ndër të tjera, me shumicë votash ka marrë vendim për ndërrimin e lokacionit të caktuar më parë për ndërtimin e godinës së spitalit të ri. Pra, bëhet fjalë për zhvillime të cilat janë duke ndodhur brenda këtyre 3-4 ditëve.

Nga informata zyrtare që ka ardhur nga kryetari i Komunës së Ferizajt, kuptohet se distanca e këtij lokacioni të ri nga kazerma ushtarake është 1 380 metra, derisa lokacioni i vjetër e ka pasur distancën 1 300 metra. Do të thotë, bëhet fjalë për një distancë pak më të gjatë sesa lokacioni i vjetër, më të larguar.

E dyta, hapësira ku është paraparë të ndërtohet spitali në lokacionin e vjetër ka qenë rreth 2,7 hektarë. Këtu bëhet fjalë tash për një hapësirë, e cila përfshin diku rreth 8 hektarë.

Pra, këto janë disa argumente, përfshirë edhe ato siç u përshkrua se bëhet fjalë për një mjedis afër parkut “Liria”. Pra, një park i cili e ka një mjedis më të gjelbëruar, si argumente të cilat shkojnë në favor të këtij ndryshimi të lokacionit.

Por, në anën tjetër, këto argumente të cilat ju po i paraqitni janë po ashtu argumente që duhet marrë parasysh me rastin e shqyrtimit të mundësisë për fillimin e ndërtimit të spitalit dhe këtë do ta bëjmë me siguri.

Ne jemi në përpjekje intensive, siç keni qenë të informuar edhe më herët, që nëpërmjet të bashkëpunimit me donatorët ndërkombëtarë, t’i gjejmë mjetet e domosdoshme financiare për përfundimin e këtij spitali.

Dua të ju informoj se jemi shumë afër realizimit të një projekti të tillë, një konstruksioni financiar, i cili në pjesën më të madhe do të mbështetet nga donatorët ndërkombëtarë, dhe kjo do të ndodhë gjatë muajit që vjen dhe gjatë vizitës, e cila do të ndodhë nga ekspertët, arkitektët e kësaj organizate, me siguri se do të qartësohen edhe këto aspekte, të cilat i

keni ngritur dhe do ta marrim vendimin më të drejtë të mundur përkitazi me këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetje shtesë, deputet? Urdhëro!

ELMI REÇICA: Unë e falënderoj ministrin Agani se vërtet kemi bashkëpunuar dhe e ka parë shumë të arsyeshme dhe është përpjekur maksimalisht që ai spital të fillojë.

Dhe, historikun e këtij spitali realisht e di jashtëzakonisht mirë dhe e ka shumë të njohur.

Esenca është që nuk qëndron, nuk është e vërtetë që është e njëjta distancë, se pas telave të kazermës është poligoni i qitjes dhe poligoni i qitjes e merr një hapësirë bukur të madhe dhe është e pavërtetë ajo çfarë ju kanë deklaruar sot në Ferizaj.

Ju e dini që kalorësit e Maltës i kam sjellë unë këtu në Kosovë, zoti ministër. Dhe, ju e dini që ata nuk investojnë në objekte. Ata investojnë në mjete, pasi të ndërtohet spitali dhe ai është një mashtim i radhës. Është për mua për t'u çuditur se komunarëve në Ferizaj u ka mbet ora në vitet e '70-ta, kur është planifikuar të pishat të ndërtohet një spital për trajtimin e të sëmurëve nga tuberkulozi. S'ka të bëjë me atë. Ju e dini që tash tuberkulozi shërohet me 5 ditë dhe me ca...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: A ke shtesë, ministër? Urdhëro, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Siç e thashë, zoti deputet, këto fakte do të verifikohen lehtë, këto janë çështje të cilat është shumë lehtë që të qartësohen sa u përket distancave, sa i përket hapësirës në dispozicion e tjera.

Sa i përket donatorit, meqenëse e përmendët, nuk desha ta përmend konkretisht pa i konkretizuar gjërat. E dini që para tri javësh ka qenë delegacioni i ... Maltës, ka qenë në vizitë edhe institucioneve të Ferizajt, e ka vizituar spitalin ekzistues, e ka vizitua edhe kryetarin e Komunës. Kërkesa për këtë ndryshim të lokacionit sipas informatës me shkrim që e kam, se nuk ka qenë në Ferizaj sot, kryetari i Komunës së Ferizajt ka qenë në vizitë te unë sot në Ministrinë e Shëndetësisë, është bërë nga Drejtoria e Spitalit të Ferizajt. Pra, edhe kjo është një e dhënë që duhet marrë parasysh me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje. Por, t'u them këtë se në një takim me rëndësi javën që shkoj, ... i Maltës e ka marrë në konsiderim të plotë edhe ndërtimin e spitalit, jo vetëm pajisjen me teknologjinë e duhur, por edhe ndërtimin e infrastrukturës së spitalit.

Se në çfarë përmasash, në çfarë mënyre, do ta qartësojmë gjatë muajit që vjen. Nuk do të shkojë larg kjo çështje. Ne shpejt do ta kemi vizitën dhe gjithë së bashku do të ulemi dhe ta gjejmë një zgjidhje më të mirë të mundshme. Por, ajo që është me rëndësi është Spitali i Ferizajt, qyteti i Ferizajt duhet të jetë me spital të ri. Pra, Spitali i Ferizajt duhet të ndërtohet, sepse gjendja ekzistuese nuk është më e tolerueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Elmi Reçica, pyetje për ministrin Agim Çeku.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje, zoti ministër,

Çështja është e njëjta, nuk do ta përsëris edhe çfarë ia bëra si pyetje ministrit Agani. Vetëm do të koncentrohem në pyetjen konkrete.

Gjeneral Çeku, ju keni qenë shëf i Shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ju e dini që Spitali Regjional i Ferizajt është themeluar kur 200 të plagosur nga Bjeshkët e Topillës, nga shpellat e Topillës, i kemi vendosur aty. Asnjë nomenklaturë politike nuk ka pasur, nuk ka denjuar faktikisht, nuk ka pasur mundësi dhe s'ka pasur guximin ta themelojë një spital të tillë. Është themeluar dhe është themeluar nga Spitali Ushtarak i Zonës së Nerodimes, kur ju keni qenë pjesë aktive e saj dhe ju e dini se çfarë kontributi kanë dhënë ata.

Është një spital që e ka një traditë të vërtetë historike dhe pikërisht për atë kemi insistuar që për atë spital e kemi zhvilluar një betejë edhe me Administratën e UNMIK-ut të asaj kohe, por edhe me nomenklaturën politike deri në vitin 2007, që Ferizaj të bëhet si regjion dhe Spitali i Ferizajt faktikisht të etablohet dhe pastaj në momentin e duhur të bëhet një investim.

Unë e them me plot gojë, kjo vlen edhe për ministrin Agani, drejtori i Spitalit Regjional të Ferizajt, unë kam qenë në atë spital dhe i kam pyetur mjekët pse keni kërkuar ta ndërroni lokacionin e spitalit, mua më janë përgjigjur para kamerave se ne nuk e kemi bërë një kërkesë të tillë.

Pyetja për gjeneral Çekun është si ministër i Mbrojtjes, faktikisht i FSK-së, por unë e konsideroj si të Mbrojtjes: A mund ta konfirmoni dhe të na informoni se a lejohet që spitali civil të jetë pranë kazermës ushtarake dhe sa është e dëmshme që këto dy institucione të jenë pranë njëra-tjetrës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Fillimisht më lejoni ta shpreh edhe një herë respektin për komandën e Zonës, për personelin mjekësor, për mjekët e Zonës së Nerodimes, për mënyrën se si e kanë organizuar dhe si e kanë trajtuar çështjen e shëndetësisë në zonë gjatë luftës.

Sa i përket pyetjes suaj konkrete, nuk është në mandatin e Ministrisë së Mbrojtjes apo Ministrisë së FSK-së sot që të lejojë apo ndalojë ndërtimin e objekteve jashtë rrethojës së objekteve ushtarake.

Është shumë e zakonshme që rreth objekteve ushtarake të ekzistojë një parametër i sigurisë, por në legjislacionin tonë pozitiv sot që e kemi sot, një gjë e tillë nuk është e rregulluar, ashtu që unë vetëm mund të jap mendimin tim.

Dua ta përshëndes dhe mbështes projektin për ndërtimin e spitalit, se Ferizaj duhet ta ketë një spital rajonal, por mendoj se vendi më i papërshtatshëm për ndërtimin e spitalit apo edhe shkollës kisha thënë është në afërsi të objekteve ushtarake, aq më shumë në afërsi të këtij objekti konkret.

Pse mendoj ashtu? Prapë po them, ky është mendimi im. Në kazermën “Skënderbeu”, ashtu quhet kazerma jonë në Ferizaj, është e vendosur komanda e trajnimit dhe e doktrinës e Forcave të Armatosura të Kosovës, në të ardhmen e shpejtë. Dhe, aty zhvillohen të gjitha trajnimet dhe të gjitha ushtrimet e të gjitha efektiveve dhe njësive të FSK-së apo Forcave të Armatosura. Aty është një frekuentim jashtëzakonisht i madh i ushtarëve, pajisjeve, automjeteve e tjerë.

Dhe, e dyta, aty i kemi dy poligone të qitjes, gjuajtjes për armë të gjata dhe për armë të shkurta, të vetmet poligone në Kosovë, të gjitha qitjet me armë sot dhe në të ardhmen do të bëhen aty.

Sot, e kemi poligonin shumë modern për qitje me armë të gjata, por shumë shpejt, para se të ndërtohet spitali, besoj, ne do të kemi atje qitje edhe me armë, që bëjnë zhurmë më të madhe dhe kanë një rreze të veprimit edhe më të madhe se sa e kanë sot pushkët dhe mendoj që një dinamikë e tillë e përditshme shkrepje me armë, ushtrime të shumta, mund të paraqesin shqetësim serioz për pacientët, për personelin mjekësor dhe mendoj që nuk do të ndjehen të qetë dhe rehat aty.

Dhe e fundit, e dimë të gjithë, çdo objekt ushtarak është cak legjitim, rentabil, i sulmit në raste të ndryshme. Kështu që mendoj që spitali, shkolla, nuk mund të bashkëjetojnë me objekte ushtarake edhe gjatë. Dhe, unë s’e kam ditur se ministri e ka të njëjtën pyetje, ishim koordinuar më mirë, por sugjerim im kishte me qenë që spitali të ndërtohet gjithsesi, por në një lokacion ...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

ELMI REÇICA: Faleminderit! Veç desha ta falënderoj gjeneral Çekun se si gjithnjë ka qenë shumë i saktë dhe shumë konciz. Faleminderit, për përgjigjen!

KRYETARI: Unë dua t’ju njoftoj kur është votuar amendamenti 3, edhe pse nuk prishet në rezultat, dikush nga grupi i Koalicionit për Kosovë të Re, ka shtypur butonin në emër të deputetit Ukë Rugova. Ju lutem, mos i bartni kartelat e huaja.

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Më fal kryetar, por këtu kartelë të Ukë Rugovës nuk ka. Nga ajo ditë që zoti Uka nuk merr pjesë në seancë, kartelë nuk ka. Unë nuk e di çka është duke ndodhur. Unë nuk po kuptoj, pra ti merri kartelat mund t’i vërtetosh...

KRYETARI: Edhe pse votimi nuk e ndryshon rezultatin se është abstënim, por këtu shkruan që Ukë Rugova, AAK - abstënim.

Këtu tash, kush e ka kartelën unë nuk e di, por elektronika e ka regjistruar.

Unë po dua ta jap këtë edhe për shkak të medieve. Elektronika nuk e di a tregon ku është i ulur, unë nuk e di, por ndoshta dikush e gjen. Emrin e kemi gjetur, kjo është kryesorja.

Prekni butonat e ta shohim, pra.

*(Ndërprerje e incizimit.)*

Mirë, sqarimin e bëjmë, po unë pa e shtypur butonin, nuk mund ta di kush është. Kur një deputet e shtyp butonin, mund ta di, por kur të votohet, mua s'ma tregon emrin e atij që voton, këtë duhet ta dini.

Unë, gjithnjë po e them, nuk e di përmendësh kush ka votuar, elektronika po e qet se Ukë Rugova, në amendamentin e tretë ka abstenuar. Kaq. Jo s'ka gabuar elektronika, tash mos ta teprojmë. U krye. Unë e dhashë sqarimin për media dhe nuk dua ta zgjas këtë pyetje më shumë.

*(Debat në sallë.)*

Unë për hir të medieve thashë, që edhe pse ka votuar abstënim, nuk ka ndikuar në rezultatin e votimit. Kaq. Urdhëro, Suzan, por s'ke nevojë ta marrësh fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Jo, kryetar, faleminderit!

Shefja e grupit tregoi që s'i kemi kartelat këtu, mirëpo edhe ne po duam për medie për ta sqaruar, të mos na bjerë hije e keqe si koalicion, sepse nuk votojmë në emër të personit, i cili nuk është këtu. Pra, është mirë që të vërtetohet kjo nëpërmjet kamerave.

Para disa ditëve administrata na i ka ndarë vetë kartelat, le të vërtetohet a është ndonjë gabim në pyetje. Këtë vetëm desha ta them.

KRYETARI: Deri të hënën, po shpresojmë që rregullohet kjo çështje.

Ju njoftoj se e kam një njoftim që është dashur ta ceku edhe më herët, por kam harruar. Ju njoftoj se deputetja Lumnije Morina, nga data 28 mars 2014 nuk është anëtare e PDK-së dhe as deputete e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Aktivitetin e saj do ta vazhdojë në radhët e Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes".

Po ashtu, edhe deputeti Emin Gërbeshi ka njoftuar se aktivitetin e vet do ta vazhdojë në radhët e Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes". Sa është numri i deputetëve të pranishëm?

Janë 46 deputetë, e ndërpresim seancën dhe e vazhdojmë të hënën, në orën 12:00.

\* \* \*

*E hënë, 7 prill 2014*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 3 prill*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 3 prill 2014.

Konstatoj se të pranishëm i kemi 64 deputetë. Nuk mund të vazhdojmë me pikën e katërt. Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

### ***5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale***

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetin Fikrim Damka, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale, në mbledhjet e mbajtura, e ka shqyrtuar Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale dhe ka vlerësuar se me këtë projektligj dhe me amendamentet e propozuara nga komisioni do të arrihet një qëllim nga objektivat me këtë ligj.

I kemi kërkuar edhe rekomandimet prej komisioneve funksionale. Të gjitha komisionet kanë rekomanduar që ky ligj nuk përmban asnjë implikim buxhetor, si dhe komisionet funksionale.

Projektligji i ka gjithsej 78 amendamente. Unë me këtë rast dua ta falënderoj deputetin Shaip Muja, i cili e ka përkrahur dhe ka dhënë disa amendamente, të cilat e kanë plotësuar këtë ligj. Sidomos ka qenë iniciator që në këtë ligj të ketë edhe produkte medicinale të veterinës. Unë besoj që me këtë ligj do të plotësohen edhe këto pajisje dhe produktet medicinale.

Unë kërkoj prej deputetëve që të votohen amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të fillojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, na duhet prania elektronike e deputetëve. Prania fizike është 68 deputetë, na duhet prezenca elektronike. Votojmë tash!

Praninë e tyre e kanë treguar 63 deputetë, edhe pse ajo fizike është më shumë. Edhe një po lajmëron që nuk ka kartelë, 70 është prania fizike, tash u bënë 64. A shkojmë edhe një herë? Shtypeni butonin të gjithë! Votojmë tash!

66 deputetë e kanë treguar praninë me elektronikë. Regjia, le të na printojë, edhe një është lajmëruar me ngritje dore. Pra, janë gjithsej 67 deputetë të lajmëruar. Afrim Kasolli është me ngritje dore. Prania fizike është 70 deputetë, 5 deputetë nuk e kanë marrë mundin ta tregojnë praninë elektronike.

*(Ndërprerje e incizimit.)*

Prania fizike tani është 71 deputetë.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve:

Amendamenti 1

Është i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. A ka kundër? Atëherë shkojmë me elektronikë.

Pra, e votojmë amendamentin 1, i propozuar nga deputeti Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 39 vota për, 19 kundër dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti.

Nuk ia dhashë fjalën deputetit se konsiderova që është në mbështetjen e Komisionit funksional dhe do të kishte nevojë arsyetimi.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Është i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Tani duhet sqarimi nga deputeti. Urdhëro deputet, e ke fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që në ky amendament, i cili është diskutuar edhe me ekspertë të fushave të veçanta të riformulohet në vijim, siç e kam formuluar unë. Mirëpo, edhe komisionit ndoshta i është përvjedhur që te produktet e falsifikuara, siç quhen, çdo ndryshim i produktit, kam thënë, ose pajisjes medicinale, që identiteti i tij ndryshon nga identiteti i produktit të regjistruar, dhe i pranuar si i përshtatshëm me lëshimin e një certificate të autorizim-marketingut, duke përfshirë edhe defektet e paqëllimshme që derivojnë nga deklaratimet e deponuara tek autoriteti që e lejon tregtimin.

Kjo mundëson uljen e falsifikimit të barnave në tregun e Republikës së Kosovës, ose keqpërdorimin në forma të ndryshme, të cilat ne edhe po i hasim në treg.

Prandaj, lus deputetët, nëse nuk kanë pasur mundësi ta lexojnë, ta shtojnë si riformulim i amendamentit që e kam propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 22 vota për, 39 kundër dhe 5 abstenime, nuk miratohet amendamenti i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 8

Janë dy propozime: i Komisionit FunkSIONAL dhe i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

E votojmë së pari amendamentin e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Konstatohet se me 56 vota për, 1 kundër dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti i Komisionit FunkSIONAL.

Me Rregullore, duhet të shkojmë në votimin të amendamentit të propozuar nga deputeti Shaip Muja. Urdhëro Shaip, e ke fjalën.

SHAIP MUJA: Nuk jep asnjë hapësirë ligjore të interpretohet ndryshe kur votohet për edhe të votohet përsëri edhe mendimi im, se kjo bie në kundërshtim.

KRYETARI: Rregullorja thotë ashtu, unë po dua të jem konform saj.

SHAIP MUJA: Unë nuk e tërheq si amendament, por mendoj që kjo duhet të rilexohet nga deputetët edhe një herë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë konsideroj që deputetët e kanë lexuar. E votojmë variantin b të amendamentit 8, propozim i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Konstatohet se me 14 vota për, 44 kundër dhe 4 abstenime nuk miratohet amendamenti 8b, i propozuar nga Shaip Muja. Pra, shkon varianti i Komisionit Funksional.

#### Amendamenti 9

Propozim i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash! Konstatohet se me 43 vota për, 14 kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miratoi amendamentin 9, i propozuar nga deputeti Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

#### Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

#### Amendamenti 11

Propozim i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Nuk janë 61 vota, edhe një herë duhet të votojmë!

E votojmë amendamentin 11, i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash! Edhe një herë, nëse dëshironi e përsëritim, por nuk ka kaluar ky amendament. Ky është vullneti juaj, deputetë të nderuar.

#### Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

#### Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

#### Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

#### Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

#### Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

#### Amendamenti 17

Është i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Nuk kalon as ky variant i amendamentit 17, i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional...

*(Reagime nga salla.)*

KRYETARI: Po nuk votohet, mu për atë që nuk i ka marrë. Për të kaluar amendamenti, unë mendoj që nuk duhet dhënë zor, mos i jepni zor. Për të kaluar amendamenti, duhet të jenë 62 deputetë që votojnë.

*(Reagime nga salla.)*

KRYETARI: ... Nuk ka nevojë sqarim, i nderuari deputet, për faktin se ti i ke propozuar amendamentet 17 edhe 18, edhe e ke përkrahjen e Komisionit funksional, por deputetët që janë në sallë nuk po duan të ta votojnë amendamentin. A po merr vesh?

*(Reagime nga salla.)*

KRYETARI: Unë po votoj, por nuk po votojnë deputetët.

E votojmë amendamentin 18, i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë tash!

Nuk kalon amendamenti.

Pra, për shkak të mungesës së kuorumit, amendamenti nuk kalon. Kjo kështu është. Vazhdojmë.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Është propozim i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Realisht, pasi është kështu, do të duhej të votohej, pa nevojë për diskutim, por nuk është vullneti i deputetëve të votojnë. Votojmë tash!

Amendamenti 27 nuk e ka kuorumin e mjaftueshëm për t'u konsideruar i miratueshëm.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29 janë dy propozime: propozimi i Komisionit Funksional dhe propozimi i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Ne e votojmë fillimisht variantin e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Me 59 vota për, asnjë kundër, dy abstenime, miratohet amendamenti 29, i Komisionit Funksional

Varianti b) është i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. E ke fjalën për arsyetim deputet dhe shpresojmë që amendamenti yt do të marrë më shumë vota se ai i Komisionit Funksional.

SHAIP MUJA: Zori, kryetar!

Ky ligj nuk është duke u bërë për mua, është duke u bërë për atë që kur të dalim prej seancës ta shohim seriozitetin sa e kanë lexuar këta deputetë që po i kundërshtojnë këto amendamente, që jam i bindur se nuk i kanë lexuar dhe nuk janë duke e ditur çka po votojnë dhe nëse në procesverbal dikush që na monitoron do ta shohë se çka janë duke votuar, është për t'u turpëruar.

Prandaj, këto amendamente të cilat unë i kam sqaruar janë amendamente të bazuara sipas standardeve evropiane, nuk janë të mendimit tim personal dhe janë të bazuara me arsyeshmëri secili. Prandaj, është në turpin e atyre që e votojnë, edhe në krenarinë kur të kërkojnë diçka për cilësinë e produkteve medicinale në Republikën e Kosovës.

Ne po lexojmë shumë gjëra. Këtu po flitet për inspektoratin në këtë nen, që shumica nga deputetët nuk e kanë lexuar dhe nesër, kualiteti i inspektorëve, i cili par sa ditësh kemi parë skandale mu për inspektorët, edhe kualiteti i monitorimit të produktit, disporsionit, monitorimit të kualitetit, e të gjitha ato kanë rrjedhur mu për shkak të kësaj që kërkoj ngritjen profesionale, sa kohëzgjatje ka pasur në këto aktivitete dhe shumë të tjera.

Sikur t'i kishin lexuar, sigurisht deputetët do të kishin menduar ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Unë vetëm kisha kërkuar që secili deputet që bën amendamente ta arsyetojë amendamentin e vet, por pa kualifikime tjera. Pa kualifikime, ju lutem! Lëri kualifikimet jashtë Parlamentit!

E votojmë amendamentin 29, i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Konstatohet se me 26 vota për, 26 kundër, 3 abstenime, nuk kalon amendamenti 29.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34 i ka dy propozime: i Komisionit FunkSIONAL dhe i deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. E kemi variantin a dhe b. Ne e votojmë fillimisht variantin a, të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 57 vota për, 2 kundër, 4 abstenime, miratohet varianti a, i Komisionit FunkSIONAL, pra amendamenti 34.

Tani deputeti Shaip Muja e ka fjalën për ta arsyetuar variantin b.

SHAIP MUJA: Zoti, kryetar!

Sado që mundohem të jem i qartë, siç duket është një interesim apriori i keqkuptimit, sepse nuk e kanë lexuar. Edhe këtu, në këtë seancë nuk mundem, por do të kishte qenë mirë që edhe kryetari i komisionit, por edhe komisioni në përgjithësi ta arsyetojnë pse kanë vendosur në këtë mënyrë dhe nuk kanë vendosur me propozimin tim.

Prandaj, në seancë mendoj që është e tepërt që të mundohemi t'i bindim deputetët pse duhet të votohet dhe është e pakuptimtë të rikthehet, kur ky veç kaloi. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, propozuesi në një mënyrë hoqi dorë nga votimi. Vazhdojmë.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Është i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Amendamenti ka marrë 54 vota për, kundër nuk ka, abstenim janë 3. Nuk e plotëson kuorumin për t'u konsideruar i votuar.

Amendamenti 41, i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Edhe amendamenti 41, i propozuar nga deputeti Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, nuk e merr kuorumin e mjaftueshëm. Urdhëro deputet, por është e dukshme që nuk po duan të marrin pjesë në votim. Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti, kryetar!

Unë dua ta falënderoj në mënyrë të veçantë komisionin për përkrahje që ka bërë, por edhe për ato kundërshtimet që i ka bërë, por nuk mund të kalojë pa e dhënë një vërejtje shumë serioze për ata persona të cilët nuk po e votojnë këtë, sepse në televizion dalin e thonë ne nuk po i atraktojmë prodhuesit. Në nenin, të cilin unë e përfaqësoj, them: autorizim për prodhimin jepet vetëm një herë dhe vlen përgjithmonë, vetëm nëse nuk tërhiqet, shuhet, suspendohet ose pezullohet. Një prodhues i cili do të vijë në Republikën e Kosovës të prodhojë medikamente, ose pajisje medicinale dhe i thuhet se ti do ta kesh licencën për 5 vjet, ai nuk është i garantuar për ndryshimet politike që mund të ndodhin në Republikën e Kosovës.

Licenca i pezullohet në rast se ai i ka shkelur në mënyrë permanente gjatë inspektimit të gjitha kushtet e parapara me ligj. Prandaj, ne apriori po u themi prodhuesve në Republikën e Kosovës, jo vetëm në barna, por edhe në çdo lëmi tjetër, që ne ju japim një lloj leje, e cila është në dorën tonë që kur të duam jua marrim, pavarësisht nëse ekziston mundësia e ligjit apo jo.

Unë mendoj që Lidhja Demokratike, e cila është duke e marrë joseriozisht këtë çështje, po shihet, mendoj se ky është një joseriozitet për një prodhues, i cili nuk vjen të financojë në Republikën e Kosovës kur e di se e ka të limituar licencën sa kohë. Licencat nuk duhet të limitohen. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Unë, zoti kryetar, vetëm shkurt po e them: është e drejtë jona të veprojmë ashtu siç ne e konsiderojmë drejt dhe në atë mënyrë edhe po sillemi dhe le të mbetet në ndërgjegjen e të tjerëve që po e vlerësojnë, ose të tij që po e vlerëson qëndrimin tonë. Ne e konsiderojmë si qëndrim të drejtë dhe i kemi arsyet pse po e bëjmë

këtë. Është e drejtë jona demokratike sikur që kanë ndodhur edhe herët e kaluara nga të tjerët dhe ne nuk jemi marrë me etiketime ndaj askujt.

KRYETARI: Shaip, një minutë!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar!

Ata që na dëgjojnë, e shohin që përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike, në këtë rast zoti Beqiri, është duke shpuar vrima në ujë, se as ky nuk e ka lexuar ligjin, ndërsa anëtarët e komisionit, ku i ka dy veta, e kanë pranuar këtë amendament dhe në këtë mënyrë ky po përpiqet të bëjë një lloj arsyeshmërie. Unë kam thënë që fushata ka filluar, por ne për hir të asaj që jemi deputetë dhe në minutën e fundit duhet dhënë një arsyeshmëri pse po rrimë, kështu që këtu nuk ka asnjë nivel të spekulimit, por ka një lloj të papërgjegjshmërisë dhe ose profesionalizëm, ose interesa të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri, kundër-replikë, një minutë!

ISMET BEQIRI: Zoti Muja, unë nuk merrem me shpime në unë, e nëse merreni ju, ju merruni me shpime në ujë, siç thoni. Është e drejtë e Grupit tanë Parlamentar, është qëndrim i grupit dhe mos na shpjegoni se çka kanë vendosur, ose si ka vendosur dikush në komisione. Kjo është çështje jona. Shumë herë këtu është votuar përkundër vullnetit tonë, e ne nuk jemi marrë me të tjerët. Është votuar nëse ne kemi llogaritur që nuk e keni mirë ju të tjerët. Ajo ka mbetur që është çështje e juaja, prandaj ky është qëndrimi ynë dhe këtë të drejtë e shfrytëzojmë.

KRYETARI: Nuk ka debat më, por përdorni drejt shprehjet popullore kur flisni, se nuk populli nuk thotë 'me shpu në ujë', por thotë 'me prashitë në ujë'.

Vazhdojmë me votimin.

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52, ka dy propozime: a) të Komisionit FunkSIONAL dhe b) të deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë variantin e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash.

Konstatohet se me 58 vota për, 1 kundër, 3 abstenime, votohet amendamenti 52, variant i Komisionit FunkSIONAL.

A votojmë amendamentin? Arsyeshmërinë e ka për variantin “b”, deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, për çështjen e zotit Beqiri që thamë, “ky jo që prashit, po shpon bira në ujë”, prapë në këtë ligj, në këtë amendament nuk është kundërshtuar plotësisht, sepse edhe Komisioni ka qenë i ndarë në dy mendime. Mirëpo, për të mos u falsifikuar medikamenti në tregun e Republikës së Kosovës, unë kam kërkuar dy parametra, të cilët janë shumë mbrojtës për kualitetin e medikamentit kur hyn në Republikën e Kosovës.

Kam kërkuar bar-kodin, i cili është tash në çdo paqetë të cigareve edhe banderola. Do të thotë, edhe mekanizmin e prodhuesit që duhet t’ua japë me bar-kod, por edhe banderolën që veç është duke e prodhuar Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale.

Prandaj, e sugjeroj prapë zotin Beqiri edhe ata që po e kundërshtojnë që ta lexojnë dhe kur të kundërshtojnë le të nxjerrin fakte. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Për amendamentin në fjalë lexojeni Rregulloren mbasi po thirreni në lexime, sot.

Tek jeni të disponuar, faktikisht jo që i kemi lexuar, por i kemi studiuar mirë të gjitha amendamentet e zotërisë edhe këtë amendamentin e fundit. Bile ky i fundit ka edhe konflikt interesi, sepse ky tenton të futë diçka të re e cila krijon drejtpërdrejt në bizneset e tyre personale dhe për këtë arsye edhe grupi parlamentar mendon që mirë ka bërë Komisioni që e hedh poshtë. Dhe, kjo është arsyeja edhe amendamentet tjera që janë kundërshtim me ligjin i cili është i sponsorizuar nga Qeveria e zotit Shaip Muja. Dhe, kjo

nuk e di pse këtu ka dilema pse ne ose dikush tjetër i kundërshton këto amendamente, kështu që edhe ky amendament duhet të kundërshtohet.

KRYETARI: Shaip, shkurt!

SHAIP MUJA: Sikur të kishte qenë në kohën e fashizmit për ta imituar Gebellsin do ta kishte marrë Poloninë pa luftë, mirëpo ky duhet të nxjerrë fakte dhe ky nuk nxjerr asnjë fakt. Ata që na dëgjojnë pak në mënyrë më shkencore, më analitike këtu nuk është duke u folur për asnjë biznes privat për askënd.

Këtu është duke u folur për fuqizimin e mbrojtjes së medikamentit në treg, kur hyn. Prandaj, jo që se kanë lexuar, sepse këtu thotë e kemi studiuar, por nuk e ka as se ka shfletuar .. Komisioni ka qenë i ndarë në dy mendime për këtë çështje, unë po kërkoj në mënyrë suplementare edhe një shtesë, do të thotë edhe një fuqizim të kontrollit. Edhe ky spekulon thotë tash ne e kemi e lexuar, ne se kemi lexuar. Kjo është jo serioze. Faleminderit!

KRYETARI: Armend, një minutë e ke kundër replikë.

ARMEND ZEMAJ: 15 sekonda! Unë e di që edhe fashizmi edhe komunizmi janë ndërlidhura njëra me tjetrën kështu që edhe ideologjia politike e zotit Shaip Muja, është goxha e njëjtë dhe nuk ka të bëjë me as ideologjinë time, as politike, as përcaktimin edhe filozofisë, subjektit politik.

Kështu që edhe në këtë aspekt unë po mendoj prapë e ka gabim dhe prapë qëndroj që këto amendamente janë tipike personale të tij dhe të grupit të tij politik.

KRYETARI: Unë mendoj që në çështjet ideologjike mos hyni se unë konsideroj që të dytë jeni të vegjël të merreni me ato sisteme të mëdha. Vazhdojmë!

Amendamenti 53

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti i 60 është i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Nuk e merr kuorumin e mjaftueshëm, 40 për, 4 abstenime, nuk ka kundër. Fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Kryetar, veç një sqarim te përkufizimet na i kemi fshirë produktet galenike, në qoftë se këtu nuk i fshimë atëherë vjen kundër, të lutem të kemi pak kujdes për këto amendamente.

Assesi nuk jemi përzier Shaipit, ne i kemi marrë unanimisht këto. Të lutem, vjen kundër e kemi bërë ligjin katastrofë.

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, nëse vendosen shumë gjëra, të cilat janë vendosur siç tha edhe kryetari i Komisionit, me përkrahjen, ky ligj do të bie në koalizion me nenet tjera.

Prandaj, për atë unë u shqetësova që ka një jo seriozitet, në çështjet që nuk janë përkrahur me komisionin ne mund të debatojmë edhe mund të gjejmë kohë që ose të riformulohen ose të ri plotësohen tash në seancë.

Por, sidoqoftë mbetet prapë në dorën e deputetëve të vendosin dhe në fund kur të votohet ligji unë mendoj që me këto veprime çfarë i kemi bërë ky ligj nuk mund të kalojë. Faleminderit!

KRYETARI: E votuam, nuk e di pse të bisedojmë tash është votuar dhe nuk ka kaluar amendamenti për shkak të kuorumit.

Kemi amendamentin 61 të deputetit Shaip Muja, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, pra ke të drejtë ta arsyetosh amendamentin Shaip.

SHAIP MUJA: Në nenin 15, paragrafi 10, kam kërkuar që të fshihet pika 10 ku thuhet: “Ministria e Shëndetësisë mund të lidhë marrëveshje me vendet e ndryshme për pranimin bilateral dhe unilateral të autorizimit për marketing nga Republika e Kosovës”.

Kjo pikë mund të interpretohet edhe për një mënyrë subjektive të lidhjeve me marrëveshjet unilaterale, prandaj nëse nuk respektohet ligji në tërësi, ministri nuk mund ta shkel ligjin për të bërë marrëveshje unilaterale, sepse bie ndesh me ligjin, të cilin jemi duke e diskutuar. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Për shkak që këtu në seancë kam ngritur njërin nga shqetësimet kryesore sa i përket falsifikimit të barnave dhe ku njerëzit janë nën aktakuza për falsifikimin e barnave dhe abuzimet në emër të asaj të produkteve galene dhe falsifikimet në të cilën ka ndodhur.

Ato falsifikime të barnave, të cilat sot po ndodhin në Kosovë, janë barnat të cilat i konsumojmë ne, janë barnat të cilat i konsumojnë fëmijët tanë dhe nuk jemi duke folur për një ligj i cili ka për t'u përdor për jashtëtokësorët, por për një ligj i cili do të jetë i zbatueshëm për popullatën tonë.

Formën se si është votuar, disa ndoshta për shkak të jo seriozitetit, disa ndoshta për inati të Shqipërisë, nuk e kanë prekur sustën e votimit, këtë ligj e kanë bërë të paimplementuar tani edhe kanë krijuar vakuume nëpërmjet të cilave do të fuqizohet falsifikimi edhe i barnave, edhe i produkteve medicinale.

Prandaj, kërkoj i ftoj të gjithë deputetët që këtë ligj sot në këtë formë çfarë ka kaluar me disa amendamente dhe disa jo, ku është bërë një përzierje, që të mos kalojë dhe të shkojë në leximin e tretë.

I ftoj deputetët që në këtë formë nuk i kanë bërë shërbim as këtij ligji, as qytetarëve të Kosovës, por e kanë krijuar një zbrazëti juridike përmes së cilës falsifikuesit, mashtruesit do të arrijnë të fusin barna në emër të produkteve të ndryshme dhe ato të shiten për fëmijët tanë dhe për popullatën tonë. Prandaj, kërkoj që ky ligj në këtë formë të mos kalojë.

KRYETARI: Shikoni, janë lajmëruar disa deputetë për ta marrë fjalën. Unë do t'i jap në emër të grupeve, por paraprakisht po dua ta them vetëm këtë, deputetët që propozojnë amendamente duhet t'i sqarojnë, t'i arsyetojnë ato. Nëse duhet t'i arsyetojnë bile në mënyrë goxha të kulturuar nëse duan t'i marrin votat e deputetëve, por mënyra qysh ju po doni nganjëherë t'i arsyetoni amendamentet realisht po irritoni të tjerët pastaj ata s'po votojnë.

Është mirë që ata që bëjnë amendamente t'i arsyetojnë thjesht në mënyrë profesionale amendamentet dhe jo të hedhin akuza këndeje apo andej.

Fjalën, në emër të "Vetëvendosjes", e ka kërkuar deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Ne i kemi përkrahur të gjitha ato amendamente, të cilat kemi menduar që janë në rregull.

Kemi qenë edhe për atë që ligji të miratohet për shkak që është një rregullim më i mirë se ai që kemi pasur deri tash, por votimi po tregon që brenda ligjit krijojmë shumë konflikte

përmes mënyrës qysh kemi votuar deri tash edhe propozoj në emër të grupit që të shqyrtohet një seancë tjetër, respektivisht të shkojë në lexim të tretë ligji, nëse pajtohen edhe deputetët tjerë.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt edhe unë e pata në plan ta propozoj një gjë të tillë për shkak se në të vërtetë kanë kaluar disa amendamente, disa tjera kanë ra dhe tani kemi problem me projektligjin kështu të paktën po thonë ata që kanë marrë pjesë në shqyrtim.

Por, unë po kam pak problem me gjuhën këtu, nëse është e vërtetë që pa këto amendamente ligji i favorizon kontrabanduesit, trafikantët, krimin me barna, çka po di unë gjithçka tjetër, e ky ligj ka kaluar në Qeveri, atëherë ne e kemi pak një problem këtu. Qeveria ka sjell ligjin, apo doni të thoni ju që Qeveria ka sjell ligjin për t'i favorizuar kontrabandistët, e krimin me barna etj., etj., edhe tash ka qenë dashur këtu në Kuvend për t' i rregulluar dikush.

Mendoj se është gabim për të thënë kështu, mendoj se po shkohet përtej, po dramatizohet tej mase domethënë kjo temë. Kështu që nuk ka nevojë për ta dramatizuar kaq shumë edhe për të thënë që ligji qysh ka ardhur prej Qeverisë i favorizon kontrabandën e krimin e çka po di gjë unë.

Edhe definitivisht që duhet edhe ministri ta thotë fjalën e vetë, për shkak se këta e kanë sjell një ligj te ne, ministri hiq nuk po i mbron amendamentet, domethënë po thotë bëni çka të doni me ligj ju tash. Mendoj që është e radhës që ministri ta mbrojë ligjin qysh e ka pru, se këto amendamente fundi i fundit janë për ta ndryshuar ligjin prej variantit të cilin e ka sjell Ministria, edhe Ministria duhet të na tregoj a po pajtohet me ndryshimet që po bëhen në amendamente apo jo. Përndryshe ne nuk po mund të marrim vesh diçka konkrete çka po ndodh. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të ndoshta të Koalicionit për Kosovë të Re fjalën e ka kërkuar deputeti Gëzim Kelmendi. Me rend jam kah shkoj. Mirë, bre edhe juve ua jap fjalën mos u mërzitni, po u përzier pak. Pra, edhe ty Shaip edhe Ismetit do t'ua jap fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari ministër,

Po pa dyshim që në ligjin i cili ka ardhur dhe pa ndërhyrjen e amendamenteve, ka qenë ligj mjaftë reformues sa i përket në të kaluar me të vjetrën dhe një ligj i cili ka siguruar qasje në çdo aspekt, qoftë për prodhuesin, qoftë për shitësin me shumicë dhe pakicë dhe pa dyshim dhe për luftimin e kontrabandimit, prandaj këto terma që u përdorën deri tash se ka hapur rrugën për kontrabandë janë në kuptim plotë të fjalës trillime dhe shpifje dejtë ligjit dhe sponsorizuesit, konkretisht nga Ministria e Shëndetësisë.

Ndërsa, unë mendoj që le të vazhdojmë me procedim të këtij projektligji, ato amendamente që votohen të kalojnë, ato që nuk votohen nuk kalojnë dhe në fund votohet ligji në tërësi. Nuk është hera e parë që ballafaqohemi me sfida të tilla.

Prandaj, është e drejtë e secilit deputet, e drejtë e secilit grup parlamentar të votojë për apo kundër. Ne nuk duhet të merremi me askënd e kemi para vetes ligjin, kalojnë ato amendamente që kalojnë, në fund votohet ligji në tërësi.

KRYETARI: Unë para se t'ia jap fjalën ministrit, dua t'ju tregoj që po kërkon shqyrtimin e tretë, po shqyrtimi i tretë nuk ua jep atë që ju po dëshironi.

Unë po lexoj pikën 2 të nenit 59. "Amendamentet që janë shqyrtuar dhe që janë refuzuar në shqyrtimin e dytë, ose që janë të ngjashme me amendamentet në shqyrtimin e dytë, nuk mund të propozohen për shqyrtimin e tretë."

Treshi, procedura e shqyrtimit të amendamenteve plotësuese dhe procedura e shqyrtimit të projektligjit të ndryshuar në leximin e tretë, duhet të jenë në pajtim me nenin 58, në leximin e dytë të kësaj Rregulloreje.

Fjalën tash, po ua jap edhe dy grupeve më të mëdha, po ia japim opozitës. Kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën, pastaj Shaip Muja në emër edhe të vetin, edhe të Grupit.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Pak a shumë e tha zoti Gjini, po edhe unë po e shpreh qëndrimin që vërtet është e pakuptueshme, se si tash një ligj që paska ardhur, tërësisht ligj që mundëson kontrabandë dhe çdo gjë gati të keqe është shpëtimtar në amendamentet që është bërë këtu, ose janë bërë, kjo për mendimin tonë nuk qëndron, e para.

E dyta, ne kemi hyrë në proces të votimit dhe ne nuk pajtohemi që të ndërpritet procesi i votimit tash për propozimet që dolën. Ne jemi që të vazhdojë absolutisht votimi, deri në fund.

KRYETARI: Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Ky interpretim që po mundohet të jepet se është sjell një ligj për të ndihmuar kontrabandimin, kjo është spekulative, po kjo tregon që deputetët të cilët sot janë duke votuar jo që s'e kanë lexuar, po s'e kanë idenë çka po shkruhet këtu.

Derisa anëtarët e Komisionit të Lidhjes Demokratike e kanë votuar këtë në komision dhe Partia Demokratike së bashku me 3 anëtarët, që unë me pjesëmarrje pa të drejtë vote kam marrë pjesë edhe në komision, kemi arritur t'i harmonizojmë me anëtarët e Komisionit.

Prandaj, unë nuk jam duke kuptuar, ne jemi duke sjell një ligj i cili vërtet i plotëson kushtet edhe me standardet evropiane. Kjo do të mbetet në procesverbal, dikush do ta lexojë.

Prandaj, këto spekulime, që mundohet zoti Beqiri t' i bëjë, po mundohet ta mbulojë paaftësinë e vet dhe të grupit, i cili nuk është bërë, ndërsa propozimi i zotit Haxhiu që të anulohet, unë nuk jam dakord, sepse nëse anulohet ligji ne do të humbim kohë për ta implementuar edhe monitorimin e mbarëvajtjes së produkteve medicinave në tregun e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

*(Debat në sallë.)*

Unë kam kërkuar që të jeni të kujdesshëm në fjalor, por është çështje e juaja.

*(Debat në sallë.)*

Fjalën e ka Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Edhe më herët, zoti Zemaj, realisht u përgjigj, unë ju lus si kryesues, si kryetar Kuvendi, ndalojuani njerëzve që s' dinë çka flasin dhe sillen me papërgjegjësi dhe fyejnë. Nuk është Shaip Muja që ia matë aftësinë dikujt ose paaftësinë, këtu po flasim për krejt grupin parlamentar dhe ne kemi shumë më të aftë se Shaip Muja, në grupin tonë parlamentar, shumë më të aftë se sa që ky mendon. Po, po e lus në këtë seancë ose disa nga deputetët që po fyejnë, të mos bëjnë gjëra të tilla dhe juve si kryetar, ose e lëmë këtë punë, nuk është kurrfarë problemi, le të vazhdojë ky. Ky nuk mund të na bind neve, tash po i tregoj shqip.

Sa herë, 50 herë kthejeni, ne kështu kemi për të votuar. Nuk është punë inati ky. Edhe ne kemi ekspertë që e kemi vlerësuar dhe konsiderojmë që kësisoj... ne llogarisim që është më së miri, po votojmë. Dhe, ky s'mund të na imponojë më sa a kemi mundur ne t'ia imponojmë këtij edhe grupit të tij ndonjë votim, herën e kaluar ose më herët, për diçka që s'janë pajtuar. Është çështje e tyre, por të mos mundohet të na bind ky diçka, që ne e kemi vlerësuar, e kemi analizuar me ekspertë 50 herë më të aftë se sa Shaip Muja.

KRYETARI: Shikoni, ju lutem, ju e dini se deputetët nuk janë për t'ia matur koeficientin e aftësisë të kurrkujt, ne jemi këtu për të miratuar ligje dhe ju lutem, në shprehjet që i përdorni në komunikim.

Jo, nuk ka debat. Fjalën e ka ministri, çka do të na thotë. Nuk ka replikë, fjalën e ka ministri.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 19 mars të vitit 2013 dhe përfundimisht nuk është e rastit, që më shumë se një vit është në komisionet parlamentare. I dimë mirë interesat të cilat janë në sektorin farmaceutik, i dimë mirë dukuritë negative në këtë sektor, në vite të tëra të akumuluar e të grumbulluara.

Ministria e Shëndetësisë e ka përgatitur një ligj të mirë, përfundimisht në tërësi me rekomandimet e ekspertëve të Komisionit Evropian të angazhuar në kuadër të projektit “Tweening”, me Institutin e Barnave nga Republika Federale e Gjermanisë. Ka qenë një ligj shumë i mirë si projektligj dhe ka mundur të miratohet shumë më herët në këtë Kuvend. Dhe, unë apeloj që ai të miratohet sot në këtë seancë dhe përfundimisht të hapim rrugë për rregullimin e këtij sektori edhe në mënyrë ligjore, sepse duhet nxjerrë shumë akte nënligjore të cilat e rregullojnë zbatimin e tij.

Përfundimisht, është ligj i cili e çrrënjës korrupsionin dhe krimin e organizuar nga sektori farmaceutik. Edhe amendamentet, të cilat u bënë ne i respektojmë si Qeveri në tërësi, natyrisht jemi të detyruar ta bëjmë këtë dhe kemi dhënë kontributin tonë edhe gjatë punës në këtë projektligj në Kuvend dhe do të respektojmë çdo vendim të Kuvendit në këtë aspekt. Faleminderit!

*(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)*

KTYETARI: ... nenin 61. I dëgjuat të gjitha çka thanë.

Votojmë tash amendamentin 61 të Shaip Mujës, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Nuk kalon. 21 për, 17 kundër, 5 abstenime, as kuorumin s’e ka.

Amendamenti 62.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 63.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 64

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 65

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 66

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 67

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 68 është i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Pra, ky s'ka nevojë për sqarim. Votojmë tash!

Për kanë votuar 41, kundër 1, 4 abstenime, nuk kalon amendamenti 68 i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL për shkak të mungesës së kuorumit.

Amendamenti 69 i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Për amendamentin 69 të deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL kanë votuar 39 deputetë, asnjë kundër, 4 abstenime, për shkak të kuorumit nuk kalon.

Po, ti mund ta bësh arsyetimin, po e ke pasur edhe përkrahjen e Komisionit, por deputetët s'e votuan. Unë nuk e di çfarë arsyetimit duhet bërë tash mbasi ka kaluar.

*(Debat në sallë.)*

Jo, s'ka nevojë, se vërtet ka shkuar.

Amendamenti 70.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 71.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 72.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 73.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 74

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 75 është i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 38 vota për, asnjë kundër, 5 abstenime, nuk miratohet amendamenti 75, i deputetit Shaip Muja, me përkrahjen e Komisionit funksional, për shkak të mungesës së kuorumit në votim.

Urdhëro, arsyetoje, po ata s'po duan të votojnë. Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,

Vërtet ky ligj me veprimet e aprofesionalistëve që nuk po votojnë e që po mundohen edhe të tërhiqen se kinse jemi, në Komision kanë treguar profesionalistet, se kemi diskutuar gjerë e gjatë. Edhe kemi arsyetuar në shumë drejtime këto, prandaj unë nuk mund të

kuptoj një qëndrim të tillë. Po, unë e kuptova kur tha zoti Beqiri: “për inati nuk po duam ta votojmë”, se nuk është çështje profesionalizmi, por është çështje inati.

Prandaj, ky veprim i tillë çon këtë ligj në çdo analizë për të mos u votuar. Dhe, ky ligj nuk mund të votohet në këtë mënyrë siç jemi duke e sakatosur. Faleminderit!

KRYETARI: I kemi edhe tri amendamente, por po dua t’ua përkujtoj atyre që s’po e dinë sa nene i ka. Ligji i ka 42 nene dhe 78 amendamente i ka pasur të propozuara.

Tash i kemi edhe 3 amendamente.

Amendamenti 76

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 77

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 78

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Prezenca fizike 68 deputetë, mund të shkojmë në votim. Votojmë tash. Lus deputetët dhe regjinë që të votojmë tash ligjin në tërësi. Me 56 vota për, 1 kundër, 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin numër 04/L-190 për produktet dhe pajisjet medicinale.

E vazhdojmë pikën e katërt, edhe pse s’e kemi kuorumin e mjaftueshëm, por kemi kuorum për ta arsyetuar ministri.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e sigurimeve të depozitave në Kosovë, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Besim Beqaj, si propozues i çështjes.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Në dhjetor të vitit të kaluar kemi nënshkruar marrëveshjen që ofron garanci për një linjë kreditore ‘stand by’ nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Është i dedikuar Fondit të sigurimit të depozitave që ka për synim rritjen e sigurisë në depozita.

Ruajtja e qëndrueshmërisë në sektorin financiar është njëra nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës duke marrë parasysh faktin që politika monetare është e limituar në instrumentet që mundësojnë intervenimin në sektorin financiar.

Sipas Ligjit për FSDK-në nga janari i këtij viti ngritët shuma e siguruar për depozitorë deri në shumën 3 000 euro dhe me këtë limit rreth 95% të depozitave në sektorin financiar mbulohen nga FSDK-ja.

Nëse e marrim parasysh kapitalin bazë të FSDK-së që e ka vlerën 22 milionë euro, me kërkesën të bordit të FSDK-së është negociuar linja kreditore stand-bay. Linja kreditore stand-bay është e garantuar dhe kap shumën 10 milionë euro dhe do të krijojë një qasje shtesë të financimit për FSDK-në, në rast nevojë. Në të njëjtën kohë kjo linjë kreditore paraqet një hap tutje drejt ngritjes së shumës së depozitave të siguruara nëpër banka dhe anëtarin në FSDK nga 2000 për llogari bankare sa është tani në 5 mijë euro deri në vitin 2018. Kjo do të ndikojë dukshëm në rritjen e sigurisë dhe rrjedhimisht edhe të besueshmërisë në sistemin financiar të Republikës së Kosovës.

Si rezultat i garancisë shtetërore të ofruar linja kreditore për FSDK-në do të ketë kushte të buta, respektivisht normë interesi 1% plus evri-bar, mundësinë e shfrytëzimit 8 vjet dhe koha për kthim 7 vjet. Ju ftoj që ta votojmë dhe të procedojmë, sepse është një kredi, edhe një herë e cila nuk do të shfrytëzohet vetëm nëse ka nevojë, pra nuk është automatikisht në fuqi menjëherë në ditën e miratimit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër! Para se t’ia japim fjalën kryetares së Komisionit, kërkoj nga regjia që t’i bjerë ziles për t’u kthyer deputetët në sallë. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadërgjonaj.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje i siguron fondit të sigurimit të depozitave të Kosovës një linjë kreditore ‘stand bay’, të ofruar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në shumën prej 10 milionë eurove, me qëllim të rritjes graduale të shumës së garantuar të depozitave nga 2 mijë euro për në 3 mijë euro dhe mundësinë e qasjes në fond në rast dështimit të ndonjë banke.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar Ligjin për sigurimin e depozitave më herët, e ka shqyrtuar dhe është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe është paraparë që fondi i garantuar i depozitave të vjen duke ku rritur gradualisht dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, pasi e ka shqyrtuar këtë projektligj, ka vlerësuar se kemi të bëjmë me një marrëveshje me kushte të favorshme ekonomike dhe që është në interes të ofrimit të sigurisë më të madhe për depozita të garantuara me Ligjin mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa njëzëri e ka përkrahur këtë projektligj dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së

garancisë për linjën kreditore për fondin e sigurimit të depozitave në Kosovë, nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

I nderuar kryetar,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën?

*(Ndërhyrje)*

E përkrahni Lidhja Demokratike. Nga “Vetëvendosja”, fjalën e ka kërkuar deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ne e kemi para nesh Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e sigurimeve të depozitave në Kosovë, përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Nëpërmjet këtij ligji Qeveria e Kosovës i jep Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim garancionin shtetëror që në rast se fondi i sigurimeve të depozitave shfrytëzon këtë shumë mjete dhe nuk është në gjendje t’i paguajë, Qeveria e Republikës së Kosovës garanton kthimin e tyre. Deri këtu gjithçka në rregull.

Ajo që nuk është në rregull është shuma e siguruar e depozitave të qytetarëve të Kosovës. Aktualisht sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës, qytetarët e vendit tonë kanë depozituar në bankat e Kosovës një shumë prej 2,4 miliardë eurosh.

Shuma e depozitave deri në 2 mijë euro kap një vlerë të përgjithshme prej mbi 300 milionë eurosh, sipas informacioneve që kam.

Kjo tregon që prej shumës 2,4 miliardë eurosh sa janë të depozituara nga qytetarët tanë në bankat tona, vetëm shuma për më shumë se 300 milionë eurosh është e siguruar dhe mund t’iu kthehet qytetarëve.

Me fjalë të tjera, në rast krizash financiare ndërkombëtare, në rast të falimentimit të bankave, në rast të çfarëdo krize financiare në Kosovë, rreth 2 miliardë euro janë të pasigurta. Në rrethana të tilla të gjithë ata të cilët deri sot kanë depozituar më shumë se 2 mijë euro mund t’i humbin ato.

Është papërgjegjësi e madhe e institucioneve tona, papërgjegjësi e Qeverisë me qytetarët e vendit një trajtim i tillë duke i rrezikuar ata që të kthehen prej qytetarë me para në qytetarë skamnorë, kur dihet se një pjesë e madhe e këtyre të hollave janë fituar me vështirësi shumë të mëdha, kur dihet se një pjesë e këtyre të hollave janë nga punëtorët tanë që punojnë në vendet perëndimore, në Irak, Afganistan e vende tjera.

Jam i bindur që shumica e qytetarëve të Kosovës që kanë depozituar në bankat e vendit, edhe pse ligji e thotë këtë, nuk e dinë që paratë e tyre nuk janë fare të sigurta në bankat e Kosovës. Mendoj që është shumë e rëndësishme që qytetarët e Kosovës të dinë që kushdo që ka në bankë mbi 2 000 euro deri më sot sipas ligjeve aktuale mund t'i humbë ato.

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme t'i bëhet presion Qeverisë që të ndërmarrë masa urgjente për të siguruar me ligj kursimet e tyre.

Qytetarët duan siguri dhe siguria e parave të kursyera është shumë e arsyeshme prandaj edhe ata i deponojnë në banka dhe nuk i ruajnë nën jastëk. Shteti si kornizë e organizimit të jetës, krijimit dhe zbatimit të normave e ka për detyrë të krijojë kushte të nevojshme ligjore që kursimet e qytetarëve të kenë një masë të madhe të sigurisë nga ajo që e kanë sot.

Kur Qeveria e Kosovës nuk ua garanton 2 miliardë euro që i keni, merreni me mend sa e lartë është siguria që kryeministri dhe Qeveria për paratë që s'i keni ua premtan në formë rritjesh rrogash, grantesh, subvencionesh në çdo lëmi.

Dhe, meqë asnjë krizë financiare ndërkombëtare nuk i rrezikon paratë e juaja, rreziku më i afërt vjen nga politika që po ndjek kryeministri dhe Qeveria e që ka për ta shtyrë vendin në një krizë të thellë financiare çka mund të shtyjë bankat në kolaps të shpejtë ekonomik duke i lënë qytetarët e Kosovës pa kursimet e tyre.

KRYETARI: Ta kryejnë shefat, se ndoshta edhe ndonjë ka vërejtje. Në emër të Aleancës, kush e ka kërkuar fjalën? Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ne, në Komision e kemi përkrahur, prandaj edhe si Grup Parlamentar do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Parlamentar, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se ne e kemi raportin me rekomandime për Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për fondin e sigurimit në depozitat në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, atëherë Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje dhe presim që të votohet.

KRYETARI: Të pranishëm janë 58 deputetë. Ministri e ka kërkuar fjalën për një shpjegim. Urdhëro, ministër!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ishim dëshmitarë të një dezinformate joprofesionale, dashakeqe dhe pa ndonjë arsyeshmëri, asnjë bazë elementare për një proces të tillë për të futur panik te qytetarët nuk ekziston.

Dua t'ju them që për të folur për sistemin bankar i ftoj të gjithë ata të cilët nuk kanë njohuri të njihen për sistemin bankar të Republikës së Kosovës. Sistemi bankar i Republikës së Kosovës është një ndër sistemet më të sigurta për momentin, është jashtëzakonisht mirë i kapitalizuar, është komplet në rritje si sektor bankar, Banka Qendrore e Kosovës i monitoron në baza ditore të gjitha bankat e Republikës së Kosovës.

Për ata që nuk e dinë, i ftoj që të informohen, por dua të them edhe një çështje që mbi të gjitha këto fondi për sigurimin e depozitave është një fond i cili është i orientuar drejt depozitarëve dhe banka ka mekanizëm të ndryshëm të sigurimeve dhe depozitarët në numër janë në 95% deri në 2 mijë euro depozita, ndërsa pjesa tjetër është e ndërmarrjeve, por ndërmarrjet në proceset e depozitimeve kanë edhe një sistem që thirret edhe fondi për emergjencat e likuiditetit, por po ju them më vjen keq që pa dije dhe me qëllim të keq tentojnë të futen këso lloj panikash.

Dua t'ju them që sepse u përmend këtu edhe rritja ekonomike, u përmend edhe borxhi, u përmenden edhe pagat, duhet t'u japë një pasqyrë të përgjithshme qytetarëve.

Një, duhet të kuptohet që borxhi publik i Republikës së Kosovës është 9,1% nga GDP dhe asnjë vend në rajon nuk e ka borxhin publik nën 50% nga GDP.

Pagat në përqindje në GDP, Kosova i ka diku rreth 9,2%, ndërsa në të gjitha vendet e rajonit, pagat nga sektori publik në përqindje të GDP janë diku rreth 11%.

Rritja ekonomike në Kosovë, këtë vit projeksioni është 4,1% dhe në vendet e rajonit është më i ulëti.

Përqindja e investimeve kapitale në buxhet është mbi 33% dhe asnjë vend i rajonit nuk e kalon 20%.

Ndërsa, nëse flasim për rritjen e kreditimit, uluni dhe shikoni të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe do të shihni, ka rritje të depozitave, ka rritje të kreditimit, ka stabilitet i cili është vlerësuar lart dhe për këtë disiplinë financiare, institucioni siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, disa herë publikisht kanë thënë që është model për rajonin sa i përket disiplinës financiare dhe sigurisë së mjeteve në sistemin bankar.

Pra, asnjë lloj shqetësimi, shqetësimet janë vetëm të padije dhe dashakeq dhe kjo duhet tu çohet mesazh shumë i qartë qytetarëve të Republikës së Kosovës se asnjë shqetësim, as në stabilitetin makrofiskal të vendit, as në aspektin e sigurisë bankare as në sigurinë e depozitave nuk ekziston, prandaj këtë po e them si ministër i Financave i cili çdo detal të sistemit financiar të Kosovës e kam në baza ditore të informuar. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Mendoj që e shfrytëzuat rastin për të bërë pak propagandë për sukseset e Qeverisë, nuk është vendi këtu.

Ajo që dihet sigurisht, sipas ligjit aktual depozitat e çdo qytetari janë të siguruara deri në shumën prej 2 mijë eurosh. Ju dilni dhe thoni që nuk është kështu vërtetoni, për ne nuk është kështu.

Me këtë kredinë e re ka mundësi deri në 3 mijë euro. Pra, nëse miratohet. Ne sigurisht që jemi për ta miratuar këtë pjesë, sepse jemi dakord, ajo që ne e kontestojmë dhe që themi është shumë problematike është që qytetarët që deri më sot që kanë më tepër se 2 mijë euro, nuk i kanë të sigurta këto mjete, sepse ligji e thotë kështu.

Kështu që kjo është ajo që na shqetëson ne, jo marrëveshja për të cilën po diskutojmë. Ajo që e ngrita unë thashë që kjo shumë duhet të ngritët, duhet të sigurohet më mirë për arsye se rrezikojmë që qytetarët e Kosovës të mbesin pa sigurimin e tyre. Këtë çështje e kemi të rregulluar me ligj dhe kjo çështje duhet të ndryshojë për arsye se nuk u garanton siguri qytetarëve të Kosovës.

Ajo që po kërkoj unë është thjeshtë që të ngritët jo deri në 5 000 euro në vitin 2018, por të rregullohet ashtu siç është edhe në vendet tjera perëndimore, qytetarët e Kosovës duhet t'i kenë të sigurta paratë që i mbajnë në banka.

Një rrezikim i stabilitetit financiar vjen pikërisht për shkak të politikës së padijshme që jeni ju duke e bërë, keni mundësi me premtimet që i keni bërë edhe si Qeveri edhe si kryeministër ta sillni vendin në krizë. Merreni e paramendoni vetëm skenarin që në qoftë se të gjithë ata që kanë kursime në një rast krize vijnë dhe i kërkojnë të hollat e tyre, s'kanë ku i marrin për arsye se 1,8 miliard eurosh janë të dhëna si kredi.

Kështu që kjo është ajo që ne kërkojmë që thjesht shuma e depozituar të mos jetë 2 mijë euro, shuma e siguruar duhet të jetë shumë më e lartë se sa kjo që është tash.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar deputet!

Po më vjen mirë që pak e patë se ku keni hyrë dhe cilat janë efektet e punës të cilën mund ta krijoni dhe të flasim për fondin e sigurimit të depozitave, po e them edhe një herë kërkon pak më shumë profesionalizëm, kërkon pak më shumë kohë për të lexuar e jo veç m' u ndalë në baza të politikës, se është dashakeqe.

KRYETARI: Ministër, arsyetoje, lëri ato të tjerat!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Jo, dhe dua të ju them kështu, në pyetjen tuaj, i nderuar deputet, sa i përket Fondit të Sigurimit të Depozitave e mbulon deri në 95% të depozitarëve, ndërsa a bën...

*(Reagime nga salla.)*

Të lutem, a po do shpjegim, ndërsa secili kreditor, secila bankë e ka nivelin e rezervave, të cilin e ka të përcaktuar në Bankën Qendrore. Prandaj, ju lutem, asnjë vërejtje, asnjë dilemë, asnjë problem, asnjë çështje do të thotë nuk është problematike në sistemin bankar të Kosovës. Dhe, do të ishte shumë keq, do të ishte me të vërtetë situatë shumë e rëndë.

Pra, unë, edhe një herë qytetarëve, sepse qytetarëve do të ju flas për këtë, asnjë lloj shqetësimi në sistemin bankar, as në stabilitetin makro-fiskal të vendit nuk ka, po e them me përgjegjësi të plotë për shkak se është një ndër vendet me politika dhe me procedurat më të sakta në nivelin rajonal sa i përket stabilitetit financiar. Pra, të gjitha këto gjëra tjera janë gjëra ditore të cilat duhet t'i trajtojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro Faton, një minutë e ke!

FATON TOPALLI: Ministri le të përgjigjet vetëm një pyetje: le të thotë a është e rregulluar deri më sot me ligj që janë të siguruara vetëm 2 000 euro, të cilat qytetarët i kanë në banka, por jo më shumë se 2 000? Prej këtij viti mund të bëhet 3000, për depozita e kam fjalën. Le t'i përgjigjet kësaj pyetje, asgjë më shumë.

KRYETARI: Ministër, shkurt përgjigju. E kemi një temë dhe të mbetemi në temë, të mos dalim jashtë temës.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Unë u përgjigja një herë, i nderuari deputet, por nuk ke mundur ta kuptosh. Po e them shumë qartë, përgjigja është kjo: Fondi për Sigurim të Depozitave siguron në nivel shteti, ndërsa të gjitha depozitat janë të garantuara në raportin bankë komerciale dhe bankë qendrore. Ky është një fond i cili është për depozita individuale, të cilat mund të vijnë si të tilla. Por, po e them edhe një herë - mjetet janë të garantuara, bankat e kanë raportin saktë sa mund të japin në bazë të depozitave edhe kredi dhe banka është e obliguar në raport me Bankën Qendrore për këtë proces.

Prandaj, ju lutem mos krijoni gjëra të cilat janë të panevojshme, sepse po e them edhe një herë janë joprofesionale dhe dashakeqe. Faleminderit!

KRYETARI: Jo e mbyllim këtu Faton, Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse kam qenë i kyçur prej fillimit në hartimin e këtij ligji dhe mendoj që është goxha një arritje, meqë kemi arritur ta bëjmë një lig për sigurimin e depozitave, ne kemi startuar në fillim me sigurimin deri në një vlerë prej 500 eurove, që normalisht e kemi kundërshtuar, me një fond gjithsej 14 milionë, dhe ndryshimin e ligjit që e kemi bërë me 2 000 euro është një gjë e mirë, por duhet ta kemi të qartë çka është.

Ky është një fond që e siguron Qeveria në rast të falimentimit. Por, kurrë nuk ndodh që të gjitha bankat e një shteti të falimentojnë. Për arsye se kur të falimentojë një bankë, bankë

gjatë likuidimit, likuidatori e ka obligim t'i kryejë të gjitha obligimet e kreditorit dhe furnitorit. Ndërsa këto janë vetëm pjesë që Qeveria i garanton. Është një fond, domethënë i cili ruhet, e që mund të ndodhë asnjë të mos përdoret.

Prandaj, nuk është mirë t'u çohen depozitarëve lajme jo të sakta për arsye se ne jemi duke u munduar që ta krijojmë një rregull që njerëzit paratë që i kanë t'i futin dhe t'i përdorin nëpërmjet sistemit bankar, dhe kjo është një e vërtetë. Paratë e njerëzve asnjëherë nuk humbin. Është fjala për depozitorët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ardian!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dashur ta mbështes Qeverinë, ose të hyj në çështje krejt politike, mendoj se është me interes të përsëritet edhe një herë mesazhi, për shkak se unë nuk besoj që qëllimi ka qenë i keq prej asaj që dëgjuam prej koleges deputete, mirëpo efektet mund të jenë problematike.

Do të thotë nuk kemi, dhe ne e dimë që nuk kemi rreziqe për humbje të depozitave, ose ndonjë efekt tjetër, për shkak se është e vërtetë që sistemi bankar në Kosovë është i rregulluar. Sikur të kishim, ne do të kishim marrë hapa të tjerë.

Një gjë tjetër që duhet përmendur është Trusti i Pensioneve, e nëse fillon të përdoret prej Qeverisë, ato janë mjete private të njerëzve, është efekt krejt tjetër ai.

Mirëpo, te bankat mendoj se është mirë të jepet edhe një herë mesazhi që jemi në rregull, njerëzit nuk kanë nevojë të frikohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët ta tregojnë praninë e tyre elektronike. Regjia përgatitu të votojmë për praninë. Praninë e kanë treguar 62 deputetë, 63, një nuk e ka treguar. U krye kjo, duhet të jenë 80 deputetë. Unë kërkoj nga Administrata që këtë prani ta përdorë për mëditjen që e marrin deputetët për praninë në sallë.

Mirupafshim në seancën e radhës!

\* \* \*

*E enjte, 10 prill 2014*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Në sallë janë 82 deputetë. E votojmë pikën, e cila ka mbetur nga seanca e kaluar, që është:

***- Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.***

Votojmë tash!

Nuk kalon, 75 vota për. Tani jemi në proces të votimit, e harroni të votoni! Kjo është përgjegjësi totale. E përsëritim edhe një herë votimin.

A është edhe dikush tjetër që nuk ka kartelë, e do të votojë për?

*(Debat në sallë.)*

Zonja Bytyçi nuk ka kartelë, zoti Halit Krasniqi nuk ka kartelë, votojnë për. Detyra jote është ta rregullosh, nuk është e imja.

Atëherë, e përsëritim votimin. Votojmë tani!

Janë 78 vota me elektronikë, 2 janë pa kartelë, zonja Bytyçi dhe zoti Krasniqi, bëjnë 80 vota për, një është abstenim. Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*